

Papa refuzon dialogun

**Tipologjitë metodologjike
të Ehli Sunetit në
marrëdhëniet me myslimanë**

**Operacionet
plastike**

**Martesa
nëpërmjet
internetit**

Kryeredaktor:
Omer BERISHA

Redaksia:
Bekir HALIMI, Talha KURTISHI,
Muhamed DËRMAKU, Agim BEKIRI,
Alaudin ABAZI, Ali SHABANI,
Lulzim SUSURI, Enver AZIZI,
Ulvi FEJZULLAHU
Sedat SHABANI

Bashkëpunëtorë:
Ekrem AVDIU, Ismail BARDHOSHI,
Enis RAMA, Ahmed KALAJA, Fadil MUSLIU

Redaktor gjuhësor:
Fatmir Baçi
Redaktor teknik & faqësës:
Halil BERISHA
Redaktor artistik & disenji:
Azem ZAIMI

Botues:
Metush MEMEDI

Adresa:
rr: 110 nr: 5, Çarshia e vjetër
Shkup 1000
e-mail: albislam@gmail.com
ems: +389 75 436 718
tel & fax: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar
pranë Agjencisë për Informata
të Maqedonisë nr. 02-124/2
ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 1500

ABONIMI NJËVJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Evropë: 20 €,
Kanada dhe Amerikë: 40 €
(në çmim janë të përfshira edhe
harxhimet postare)

NUN-R DOEL
Xhironlogaria: 300000001759616
Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denar)
Xhironlogaria: 0270100209184
Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro)
Rr: "Kej Dimitar Vlahov" 4
S.W.I.F.T.: KOBSSMK2X
IBAN MK07300701002091869
Numri tatimor: 4030003487017

alb
ISLAM

DEL NË FILLIM TË MUAJIT



**Hapësirë
për
reklamën
tuaj**



ROB I ALLAHUT

3

Nëse singerisht kërkojmë lirinë dhe assesi nuk e durojmë robërinë, atëherë ajo që duhet të bëjmë vërtet është një gjë të vetme - të bëhemi robër të Allahut.

Sot flitet, shkruhet e diskutohet për lirinë ndoshta më shumë se kurrë më parë, por po aq e largët duket ajo në kuptimet e atyre që e lakojnë, saqë nëse i pyet, vëren qartë se shumë prej atyre që flasin në lidhje me këtë temë, përgjithësisht as nuk dinë ta përkufizojë lirinë e aq më pak e kuptojnë, ndërsa për ta vënë në jetë as që bëhet fjalë.

Është krejtësisht normale të rastisësh me përkufizime nga më të ndryshmet, lidhur me lirinë dhe robërinë, si rrjedhojë e ndryshimit ndërmjet mendësive që ekziston ndërmjet njerëzve, kështu secili flet në masën që kupton dhe shpesh kuturu, ashtu si ia ka anda. Nuk lypset që të gjithë të jenë të njëjtë, ngase një dëshirë e tillë do të vinte ndesh me urtësinë e krijimit të Allahut, por mendimet e ndryshme në gjëra thelbësore pengojnë ecurinë e shëndoshë drejt suksesit dhe lumturisë. Me siguri që pajtoheni me mendimin se ka gjëra madhore, por fatkeqësisht, edhe rreth tyre ka pikëpamje të ndryshme. Kjo është diçka nga e cila nuk mund të ikë e as të shmangët asnjë njeri, përderisa të gjithë janë të ndikuar nga faktorë të shumtë, të ngjashëm e të ndryshëm. Fjala vjen, nëse deri dje të gjithë janë pajtuar se *nderi* është vlerë absolute, sot ke mundësi të dëgjosh syresh që thonë se ai nuk është asgjë përpos kufizim i lirisë, ose ndryshe robërim. Prandaj nuk është habi kur dëgjon se dikush ka një "baba" me të cilin jeton, ndërsa është lindur nga sperma e njëfarë "babait" tjetër, i cili është donator sperme.

Kjo dhe për shumë çështje tjera jetike si kjo, duhet doemos të gjendet rrugëzgjdhja e vërtetë dhe e drejtë, që edhe pse ka mjaft vështirësi, gjithësesi qëllimi i saj është të shpëtohet njeriu nga vështirësi më të mëdha nga ato në të cilat ndodhet.

Për këtë arsye, nëse unë abstenoj nga një "e mirë rrethanore" për hir të Allahut, mos më thuaj se nuk jam i lirë; nëse unë veproj diçka "të vështirë" për hir të Allahut, mos më thuaj se jam i ngarkuar dhe nuk jam i lirë. Fakti që unë abstenoj diçka apo ngarkohem me diçka tjetër, kjo ndodh sepse e kam kuptuar se gjërat e mëdha si përparimi, zhvillimi, krenaria, kënaqësia, lumturia dhe më e rëndësishmja: fitimi i Xhenetit, arrihet vetëm nëse respekton porositë e Krijuesit të Gjithëdijshtëm. Prandaj, me gojën plot mund të them: Sa robëri e mirë është robëria ndaj Zotit, i Cili vazhdimisht ndihmon robin e Vet për nga e mira dhe kujdeset për përfundimin e të mirës në vendin e sigurtë. Sado e madhe qoftë lodhja dhe përpjekja, ajo gjithmonë ka vlerën e pamatshme përderisa drejtohet për nga shpëtimi i sigurtë.

Allahut nuk i pakësohet mbretëria, nëse refuzojmë të jemi robër të Tij, sepse fundja, që të gjithë me apo pa dashje janë robër të Tij, muslimanë e jomuslimanë, sepse për shpirtin e secilit njeri vetëm Ai vendos. E jona është të zgjedhim, do bëhemi robër të padëgjueshëm - gjë që padyshim ka jetë të ngushtë në këtë botë ndërsa, në botën tjetër do të ketë një përfundim edhe më të keq akoma - ose të bëhemi robër të përlulur e respektues të Allahut, krenarë dhe faqebardhë në këtë botë, ndërsa në botën tjetër përfundimi i mirë si shpërblim, Xheneti i premtuar. Allahu na dhëntë sukses drejt atij shpërblimi.

Para se të filloni leximin e materialeve tepër interesante që i kemi përgatitur për ju, do të kisha shtuar edhe si më poshtë:

Duke e krahasuar me robërinë që njihet, shumë njerëz ngurrojnë të shprehin fjalën: Unë jam rob i Allahut. Por, të qenit rob i Allahut është privilegj dhe aspak nënvlerësim, siç është rasti me shprehjet: rob i parasë, rob i supozimeve etj. Shumë fjalë mund të kenë kuptim të mirë a të ligë varësisht nga fjalia ku gjenden. Nuk do tingëllonte mirë nëse themi: "Liri për zul-lumqarët", ndërsa shumë bukur do tingëllonte nëse themi: "Liri për Kosovën".

Shpresojmë që në muajin e ardhshëm të këmbëjmë urimet për pavarësinë e Kosovës.

Në emër të redaksisë:
Omer BERISHA

albiSLAM

Faqe 5 "Kryetari besimtar"



Faqe 7 Papa refuzon parimin e dialogut me myslimanë



Faqe 12 Kthejani xhamive pozitën e tyre



Faqe 16 Mbi optimizmin, shpresën dhe gjendje të tjera



Faqe 18 Çelësi i urtësisë



Faqe 22 Tipologjitë metodologjike të Ehli Sunetit në marrëdhëniet me myslimanë



Faqe 31 Operacionet plastike



Faqe 38 Portretizimi dhe karakteristikat e mynafikut



Faqe 42 Martesa nëpërmjet internetit



Faqe 46 Dosja e gabimeve që bëj ndaj fëmijëve të mi




Faqe 50 Drejtuar grave të hoxhallarëve



Faqe 53 Mes'hi mbi çorape



Faqe 57 EZANI



Faqe 61 Prezantim i librit "Esenca e dispozitave të legjislacionit islam"



"Kryetari besimtar"

5

Xhemal SULTAN

Disa prej nesh në Egjipt talleshin me deklaratat e njohura të Enver Sadatit "unë jam kryetar musliman i një shteti musliman" dhe nga përshkrimi të cilin ia jepnin njerëzit e tij si "kryetar besimtar". Disa e konsiderojnë ekstremizëm fetar ose fenomen i prapambetjes, tipare të botës së tretë dhe në kundërshtim me shekullarizimin. Mirëpo kampanjat aktive të zgjedhjeve amerikane këtyre ditëve sigurisht se do të kthejnë vlerën e fjalës se kryetarit Enver Sadat, sepse edhe kandidatët amerikanë thonë fraza edhe më të thella fetare ose më ekstreme fetarisht nga ajo që ka thënë Sadati sipas vlerësimit të disave.

Kandidati i dukshëm demokrat Obama u kujdes që fillimin e kampanjës së tij ta fillojë prej kishës, e cila është çështje simbolike shumë e qartë, publikon në mesin e miliona njerëzve foto duke u lutur në kishë së bashku me familjen e tij KJO ËSHTË NJË BOX, kurse poshtë shënon me shkronja të mëdha "krishterë praktikant", shprehje të cilën zakonisht ia atribuojnë ithtarëve të xhemateve islame. Kurse rivalët e Obamës kanë përhapur nëpërmjet postës elektronike anembanë Amerikës se Obama është musliman, gjë që atje u konsiderua si shpifje që shembë kontributin e tij për të arritur kandidimin e partisë demokratike, që domethënë i bëhet e pamundshme të arrijë të bëhet kryetar i



Nëse këtë frazë "kryetar besimtar" do ta kishte thënë ndonjë kandidat për deputet madje edhe për këshill komunal në disa vende islame, do të burgosej, e jo vetëm të pengohej nga kandidimi, me akuzë se kërcënon sistemin shekullarit.

Artikujt e paraqitur në këtë rubrikë janë mendime dhe komente personale të autorëve dhe nuk korrespondojnë patjetër me atë që redaksia i di për të vërteta

1 Janar 2008
23 Muharem 1429

albiSLAM

Aktuale

shteteve të bashkuara të Amerikës, duke qenë musliman. Organizatorët e kampanjës së Obamës i dhanë përgjigje të fuqishme këtyre shpifjeve, e cilësuan se është çmenduri, kurse Obama u kujdes të ligjëron në kishë që të potencon mohimin e akuzës e tha se rregullisht shkon në kishë, u kujdes të jetë preciz, e tha

prej njëzet viteve, kurse ata që ishin aty i dhanë një duartrokitje frenetike nga ata që ishin të pranishëm më atë ligjërim. Obama shtoi se ka dhënë betimin kushtetues duke venduar dorën mbi Bibël. Organizatorët e kampanjës së Obamës shpërndanë një letër të hapur nga shtatë kongresmen hebre që e kundërshtojnë sulmin ndaj Obamës dhe akuzimin e tij se është musliman. Organizatorët i mbushën kishat e Karolinës Jugore me plakata dhe foto që potencojnë përkatësinë krishtere të Obamës. Në disa këto foto Obama shfaqet duke u lutur, kurse nën këto foto me shkronja të mëdha shkruan **“krishterë praktikant”**. Te disa foto tjera shkruante se Obama do të bëhet kryetar, të cilin do ta udhëheq besimi i tij i krishterë.

Një plakat ka pjesë të fjalimit të tij ku mes tjerash thotë **“besoj në forcën e lutjes”**. Në një foto tjetër shfaqet Obama me anëtarët e familjes, kurse nën te shkruan “Anëtar aktiv në kishën uniteti i treshit të Krishtit në Çikago”. Obama e komenton këtë plakat duke thënë se ai “ka ndjerë

Problemi nga i cili vuan Obama dhe beson se do të jetë problem i cili do ta largon nga garat e kandidimit për kryetar është fakti se rrënjët e tija nga prindi i ka islame.


Kandidati i dukshëm demokrat Obama u kujdes që fillimin e kampanjës së tij ta fillojë prej kishës, publikon në mesin e miliona njerëzve foto duke u lutur në kishë së bashku me familjen e tij.

thirrjen e shpirtit të shenjtë dhe i ka besuar Krishtit gjatë tërë jetës”. Problemi nga i cili vuan Obama dhe beson se do të jetë problem i cili do ta largon nga garat e kandidimit për kryetar është fakti se rrënjët e tija nga prindi i ka islame. Këto fjalë nuk janë të miat por janë analizat e publikuara në gazetarinë amerikane

dhe faqet e tyre elektronike. Obama, kryetari i supozuar, i Sh.B.A-së insiston se është “kryetar besimtar” të një shteti krishterë. Është për tu habitur! Nëse këtë frazë “kryetar besimtar” do ta kishte thënë ndonjë kandidat për deputet madje edhe për këshill komunal në disa vende islame, do të burgosej, e jo vetëm të pengohej nga kandidimi, me akuzë se kërcënon sistemin shekullarit. Këtë mani fetare të cilën e udhëheq kandidati i partisë demokratike vjen si zhvillim i natyrshëm i garës, të cilin e filloi partia republikane, kurse kulmi ishin deklaratat dhe veprimet e kryetarit Bush, i cili mbante ndëja të përditshme të lutjeve të mëngjesit në Shtëpinë e Bardhë, në të cilën i detyronte edhe nëpunësit e mëdhenj.

Ne mund të parafytyrojmë ardhmërinë e kësaj mendjeje dhe shpirti, i cili dominon kryetarin e ardhshëm amerikan, me të cilat do të udhëheqë politikën amerikane në botë, me të gjitha pasiguritë dhe trazirat fetare, sektare, rasore dhe civilizuese.

Përktheu: Bekir Halimi



Papa refuzon dialogun

Papa refuzon parimin e dialogut me myslimanë

Prof. Dr. Kha'fer Shejh IDRIS

Personalitete të dalluara islame, numri i të cilëve arrin 138, i dërguan një letër Papës dhe disa personaliteteve të mëdha të krishtera në botë. Në atë letër iu drejtuan me emrat dhe titujt më të dashur për ta. Kjo letër u dërgua -

siç theksohet në tekst - me rastin e Fitër Bajramit të këtij viti dhe mbante emrin: **“Fjalë e drejtë midis nesh dhe jush”**. Shumë prej tyre e mirëpritën këtë letër, ndërsa Papa as që ktheu përgjigje, u mjaftua që me këtë çështje të merret

Aktuale

përgjegjësi për dialog ndërfetar në Vatikan. Ky përgjegjës, kardinali **Xhon Luj Tiran**, për një gazetë të përditshme katolike në Francë, 26 tetor (d.m.th. trembëdhjetë ditë pasi ishte dërguar kjo letër), thotë: “Sinqerisht, të bëhet dialog i vërtetë me myslimanët është çështje e rëndë, sepse ata Kur’anin e besojnë se është fjalë e Zotit, madje, edhe çdo shkronjë. Myslimanët nuk pranojnë që përmes thellimit të polemizohet rreth Kur’anit, sepse besojnë se ai është shkruar me diktim nga Allahu. Sipas këtij komenti as që kemi mundësi të polemizojmë rreth çështjeve të besimit”.

E formuluar kësisoj, kjo deklaratë përmban mjaft kontradikta:

Së pari: Si mund ta kushtëzosh në dialog kundërshtarin që të pajtohet me ty? Si kërkon nga myslimani, që, nëse do që të debatojë, duhet të braktisë besimin që Kur’ani është fjalë e Allahut dhe të mendojë njëlloj siç mendoni ju për librat tuaja, se ato janë libra të shkruara nga njerëz të inspiruar?!

Së dyti: Dialogu me kundërshtarin, qoftë edhe në çështjet më të rëndësishme është i mundshëm, madje, ato janë shtytëse për dialog. Është i mundshëm përderisa kundërshtari i përmbahet rregullave të logjikës, për të cilat janë pajtuar njerëzimi.

Ajeti nuk mohon se edhe jomyslimanët e duan Allahun, por ajeti thekson se besimi në Allahun detyron që askënd të mos e duam ashtu si e duam Allahun apo më tepër. Mirëpo, në këtë gabim bien shumica e krishterëve, sepse ata e duan Isain sikurse e duan Allahun ose dhe më shumë.

Pra, ka mundësi që Papa të bëjë dialog, ose të dërgojë zëvendës, duke përdorur ato rregulla logjike që t’i bindë myslimanët se Kur’ani nuk mund të jetë fjalë e Zotit, e pastaj t’i dëgjojë argumentet e tyre se ky Kur’an nuk mund të jetë tjetër përveçse fjalë e Zotit.

Së treti: Feja nuk do të kishte kuptim sikur të mos ishte nga Zoti i botëve, sidomos nëse është nga fetë që cilësohen si qiellore. Kështu

besonin shumica e të krishterëve dhe shumë prej tyre ende kanë këtë besim, d.m.th., besojnë se Dhjata e re është fjalë e Zotit dhe aty nuk mund të ketë asnjë gabim, prandaj edhe e besojnë atë libër, e quajnë të shenjtë dhe mundohen ta kenë si udhërrëfyes në këtë jetë.

Së katërti: Besimi se librat që njihen si të shenjta janë të shkruara nga njerëz të inspiruar është çështje në të cilën u detyruan të shpreheshin dijetarët e krishterë, për shkak të studimeve shkencore që u bënë rreth historisë, përkthimit dhe divergjenca e atyre librave. Madje, njëri prej tyre, në një nga librat më të reja në këtë temë thotë: “Numri i divergjencave midis burimeve të librit të shenjtë është i barabartë me numrin e fjalëve të vetë librit”.

Në atë libër u gjetën shumë pretendime që binin ndesh me të vërtetë

tat shkencore, çka bëri që shumë prej tyre të thonë - gjë që është e vërtetë - se sikur të ishte fjalë e Zotit, nuk do të gjenim kësisoj gabime, sepse Zoti është Krijues i gjithësisë dhe nuk ka mundësi të gabojë kur flet për krijesat e Tij.

Së pesti: Përse kërkojnë që myslimanët të mendojnë për Kur'anin njëloj siç mendojnë të krishterët për dy dhjatat, të vjetrën dhe të renë, ndërsa dihet se studiuesit e Kur'anit, madje, edhe nga jomyslimanë, madje, edhe disa syresh të specializuar në studimin e librave të tyre, thonë: Kur'ani është i vetmi Libër fetar historik dhe Muhamedi është i vetmi pejgamber historik. Me fjalën historik rrahin të thonë se vetëm këto janë të vërtetuara historikisht.

Së gjashti: Nëse studimet shkencore kanë detyruar të krishterët e perëndimit të besojnë se librat e tyre nuk janë fjalë e Zotit, ne ua bëjmë me dije se të njëjtat studime lidhur me Kur'anin përforcojnë besimin se Kur'ani nuk mund të jetë fjalë e askujt përveçse e Allahut të Lartësuar. Për shkak se aty gjetën shumë pajtueshmëri me të vërtetat shkencore, të cilat nuk ishin të njohura në kohën e Resulullahit, salAllahu alejhi ue selem, madje, nuk u bën të njohura përveçse në kohët e sotme.

Si mund të besosh se Allahu të ka krijuar, të jep risk dhe të ofron çdo gjë që ka nevojë trupi yt, mirëpo Ai nuk të ofron atë që është më e rëndësishme se kjo, udhëzimin në atë që të afron tek Allahu dhe që bën të arrish kënaqësinë e Tij?!

Së shtati: Përse ai besim në të cilin u detyruan të krishterët, duhet të përgjithësohet si rregull, se ashtu janë të gjitha fetë? Përse të thuhet se Allahu ka mundësi të inspirojë dikë nga krijesat që të thotë fjalë të shenjta, mirëpo nuk ka mundësi që t'i shpallë dikujt fjalët e Tij origjinale?! Kur'ani na mëson se ata që mohojnë dërgimin e pejgamberëve dhe shpalljet e zbritura, ata nuk e njohin Allahun ashtu si duhet. Ai thotë: **“Ata nuk e njohën Allahun ashtu si duhet kur thanë se Allahu nuk i ka shpallur askujt asgjë”**. (En'am 91).

Në njëfarë mënyre Kur'ani na thotë: Si mund të besosh se Allahu të ka krijuar, të jep risk dhe të ofron çdo gjë që ka nevojë trupi yt, mirëpo Ai nuk të ofron atë që është më e rëndësishme se kjo, udhëzimin në atë që të afron tek Allahu dhe që bën të arrish kënaqësinë e Tij?!

Së teti: Duke qenë se inspirimi nuk e siguron fjalën e personit të inspiruar nga gabimet, gjë që është normale, atëherë është normale edhe të pranohet ose të refuzohet fjala e tyre. Me këtë, shohim se nuk ka asnjë dallim mes atyre të inspiruar dhe njerëzve tjerë jo “të inspiruar”, qofshin ata mendimtarë, filozofë, artistë ose politikanë. Pasi të gjithë gabojnë dhe ia qëllojnë, atëherë pse shenjtëria e

fjalëve të përkufizohet vetëm në shkrimet e të inspiruarve, pse të thirren njerëzit në besimin e tyre dhe të mendojnë se vetëm ashtu do shpëtojnë?!

Së nënti: Prej tërë kësaj që përmendëm shohim se shkaku kryesor i refuzimit të dialogut me myslimanët nga ana e Papës dhe e titullarëve të tjerë është qëndrimi i dobët i tyre dhe bindja se në një dialog shkencor fetar vetëm ata do të ishin Humbësit.

Rreth letrës së dërguar:

Dialogu me jomyslimanët është çështje e kërkuar nga natyra e daveit (thirrjes), të cilin jemi urdhëruar ta bëjmë. Nuk mundesh ta thërrasësh dikë në të vërtetë, në rast se ai të pyet apo ka diçka të paqartë, dhe ti i thua: Këtu po ndahemi, nuk ia vlen të flasësh me ty!

Dialogu është syresh e ashtu edhe pjesëmarrësit në dialog. Nga përvoja kemi mësuar se dialogu më frytdhënës është dialogu me njerëzit e thjeshtë, kam për qëllim njerëzit që nuk janë të sprovuar me ndonjë pozitë apo pasuri, që do t'i pengonte nga pranimi i të vërtetës. Por, ndonjëherë mund të shfaqet nevoja për dialog dhe thirrje edhe të ndonjë personaliteti të madh.

Gjëja me të cilën do të dallohej një

"Singerisht, të bëhet dialog i vërtetë me myslimanët është çështje e rëndë, sepse ata Kur'anin e besojnë se është fjalë e Zotit, madje, edhe çdo shkronjë.

Myslimanët nuk pranojnë që përmes thellimit të polemizohet rreth

Kur'anit, sepse besojnë se ai është shkruar me diktim nga Allahu.

letër drejtuar jomyslimanëve është qartësia. Një qartësi që nuk do të zvogëlonte rëndësinë e saj, nëse do bëhej në metodën më të mirë. Mirëpo, këtë letër e vërejta se ishte kontradiktore mes dy gjërave: mes porosisë që të krishterët të lexonin disa tekste nga librat e tyre dhe t'i përthithnin sipas një kuptimi, që, sipas letrës, do t'i sillte në pajtim më atë që gjendet në Kur'an dhe mes pranimit hipotetik se mes myslimanëve dhe të krishterëve ka gjëra vërtet të përbashkëta,

gjë e cila do t'i shtynte drejt ndihmës reciproke dhe jo paragjykit apo polemikave.

Në paragrafin e dytë, letra thotë: "Njësimi i Allahut, detyra e dashurisë ndaj Tij dhe detyra e dashurisë ndaj fqinjit konsiderohen si gjëra që vërtet janë të përbashkëta mes Islamit dhe krishterimit".

Sakaq, për Njësimin argumenton me ajetin: **"Thuaj: Allahu është Një. Të gjithë janë të nevojshëm për të"**, (Ihlas 1-2), mirëpo nuk e lexojnë këtë sure deri në fund, prej të cilës bëhet shumë i qartë fakti që Allahu nuk ka lindur dikë, nuk është i lindur dhe nuk ka asnjë të barabartë, çka është pikë kyçe në njësimin e Tij. Prandaj, ai që mohon diçka nga këto cilësi, nuk mund të thotë se edhe ai e beson Allahun Një,

siç janë të krishterët që besojnë se Allahu ka fëmijë, i cili është i barabartë me Të.

Më pas, kjo letër thotë: “kështu që, duke iu përgjigjur asaj që gjendet në Kur’an, ne myslimanët i thërrasim pasuesit e Isait që të bashkohen me ne, mbi bazat e përbashkëta që kemi, gjëra që janë thelbësore edhe në fenë tonë. Pra, i thërrasim në këto dy porosi të dashurisë”.

Dy porosi të dashurisë, sikur e sqaron letra janë: dashuria ndaj Allahut dhe dashuria ndaj fqinjit. Mirëpo dashuria e tyre ndaj Allahut dhe pretendimi se kjo është nga gjërat e përbashkëta mes nesh, nuk është e njëjta dashuri, sikur bëhet e qartë edhe në disa vende të vetë letrës dhe që mund ta kuptojë secili i krishterë po të meditonte më thellë. Këta të letrës argumentojnë me ajetin: **“Ka prej njerëzve të cilët përveç Allahut besojnë edhe zota tjerë dhe i duan ashtu sikur e duan Allahun, por ata që besuan e duan Allahun edhe më shumë”**. (Bekare 165).

Ajeti nuk mohon se edhe jomyslimanët e duan Allahun, por ajeti thekson se besimi në Allahun detyron që askënd të mos e duam ashtu si e duam Allahun apo më tepër. Mirëpo, në këtë gabim bien shumica e krishterëve, sepse ata e duan Isain sikurse e duan Allahun ose dhe më shumë. Prandaj, disa syresh që iu dërgua kjo letër u përgjigjën se në

Shkaku kryesor i refuzimit të dialogut me myslimanët nga ana e Papës dhe e titullarëve të tjerë është qëndrimi i dobët i tyre dhe bindja se në një dialog shkencor fetar vetëm ata do të ishin humbësit.

atë letër komprometohej Isai.

Po ashtu, nuk duhet harruar se në Islam dashuria ndaj Allahut është e lidhur ngushtë edhe me dashurinë ndaj Resulullahit, salAllahu alejhi ue selem, çka theksohet edhe në letër, ku argumentohet me ajetin fisnik: **“Thuaj: nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua (Muhamedin), atëherë edhe Allahu do t’ju dojë juve dhe do t’ua falë gabimet. Allahu është Falës dhe Mëshirues”**. (Alu Imran 31).

Prandaj, kur shikojmë tekstet Islame (Kur’an dhe sunnet) me një shikim të plotë, na bëhet e qartë se nuk ka asgjë të përbashkët mes nesh dhe të krishterëve në çështjen e njësimi të Allahut dhe dashurisë ndaj Tij. Mirëpo kjo nuk e pengon aspak bashkëjetesën, madje, as edhe bashkëpunimin me ta në gjëra që mendojmë dhe mendojnë se janë në të mirën e Fesë dhe të dynjasë.

Kuptimi i tërë kësaj është se, dashuria e vërtetë që do të japë fryte pune, me të cilat arrihet kënaqësia e Allahut, është ajo dashuri e ndërtuar mbi pasimin e Pejgamberit që e ka dërguar Allahu i Madhëruar.

Përktheu: Omer Berisha

Kthejani xhamive pozitën e tyre

Dr. Salih b. Feuzan EL-FEUZAN

Anëtar i Akademisë së Dijetarëve të Mëdhenj

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të gjithë botëve, i Cili urdhëroi në nxitim për punë të mira dhe qor-toi nga humbja e kohëve dhe viteve, dëshmoj se nuk i takon adhurimi askujt tjetër pos Allahut, i Cili është Një, i pashoq në zotërimin dhe adhurimin e Tij dhe i pashoq në emrat dhe cilësitë e Tij, po ashtu dëshmoj se Muhamedi është rob

dhe i dërguari i Tij, i cili inkurajoi në nxitim për prani në bashkim dhe shoqëri, lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij të cilët garuan në vepra të mira.

Allahu subhanehu ve teala thotë:
“Nxitoni drejt faljes nga Zoti juaj dhe xhenetit të gjerë sa qielli dhe toka, i



cili është përgatitur për ata që besuan Allahun dhe të dërguarit e Tij. Kjo është mirësi që Allahu ia jep kujt të dojë, Ai është bamirës i madh". (Hadid 21)

Dijeni se kohët dhe vitet kalojnë, ai që frikohet bën gatishmëri, e ai që bën gatishmëri arrin në vendin e duhur, vërtet malli i Allahut është i shtrenjtë e malli i Allahut është xheneti, e xheneti nuk arrihet me shpresa, as për hir të prejardhjes, as me veprën e baballarëve dhe gjyshërve, e as me shumë pasuri dhe fëmijë. Allahu thotë: **"Nuk është as pasuria juaj, e as fëmijët tuaj ajo që ju afron pranë Nesh, është vetëm besimi dhe veprat e mira; të tillët shpërblehen shumëfish për atë që vepruan dhe ata janë në dhoma të larta të shpëtuar"**. (Sebe 37).

Ai që është i ngadalshëm në veprën e tij nuk i bën dobi prejardhja e tij, xheneti është për atë që besoi dhe bëri vepra të mira edhe në qoftë se është zezak dhe xhehenemi është për atë që bëri kufër (mosbesim) Allahut edhe në qoftë se është nga fisi i nderuar kurejsh.

Ne shohim shumë prej atyre që janë përtacë në veprat e mira dhe aktivë në kërkimin e kësaj bote dhe zgjerohen në sakrifikimin e vetes në atë që dëshirojnë. Të marrim një shembull sa i përket lidhjes së shumë prej njerëzve me xhamitë dhe praninë e tyre në ditën e xhuma dhe me xhemat. Shohim shumë prej tyre që jetojnë rreth xhamive e nuk hyjnë në të dhe as që dinë se çfarë ka brenda saj; janë përreth xhamive me shtëpitë e tyre, kurse me zemra janë larg tyre, e kjo aludon për besimin e tyre të dobët apo

O robërit e Allahut, kini frikë Atë dhe kthejani xhamive pozitën e tyre në zemrat tuaja, shkoni herët në xhami dhe shtojeni qëndrimin tuaj në të.

për mos ekzistimin e saj, për arsye se gjallërimi i xhamive bëhet me namaz dhe ibadet. Allahu thotë: **"E drejtë e përkujdesjes së xhamive të Allahut është vetëm e atij që i ka besuar Allahut dhe ditës së mbramë e që e falë namazin, jep zeqatin e nuk i frikësohet askujt pos Allahut. Syresh do të jenë**

të udhëzuarit".

Muhamedi salallahu alejhi ue selem, thotë: **"Nëse shikoni një njeri që i ka bërë traditë xhamitë, dëshmoni për besimin e tij"**. Dhe lexoi ajetin e lartpërmendur.

I shikon këta, mbushin tregjet dhe ushqehen me furnizime e nuk drejtohen drejt xhamive që të marrin pjesë me myslimanët në kryerjen e ceremonive fetare. Allahu thotë: **"Ata i ka nënshtruar djalli dhe ua ka qitur në harresë porositë e Allahut. Ata janë shoqëri e djallit, e dijeni se ithtarët e djallit janë më të dëshpëruarit"** (Muxhadele 19).

Ia ndaluan vetes shpërblimin e të ecurit deri në xhami dhe të mirat që janë në të, shlyerjen e mëkateve dhe kështu mëkatet u mbeten në qafët.

Disa të tjerë, të cilët janë shumë, vijnë në xhami me përtaci dhe molisje dhe kalojnë një kohë të pakët me lodhje dhe mërzë, e shumë prej tyre kur dëgjojnë ikametin vijnë me shpejtësi dhe hyjnë në namaz jo të qetë.

Nuk ka pasur kujdes në edukatën e hyrjes në xhami e as që ka vepruar me sunetin e Muhamedit salallahu alejhi ue selem, i cili thotë: **"Nëse dëgjoni ikametin, ecni duke qenë të qetë, atë që do ta arrini faleni dhe ajo që do t'ju kalojë plotësojeni"**. U ka ikur shpërblimi i të shkuarit në xhami

dhe shpërblimi i pritjes së namazit, e Muhamedi sala-llahu alejhi ue selem, na lajmëron se për atë që ulet dhe pret namazin në xhami, shpërblimi është i njëlojtë me atë të njeriut që është në pozicion të luftës në rrugë të Allahut, dhe atij i shkruhet shpërblimi i atij që fal namaz derisa ai

është duke pritur namazin dhe melekët kërkojnë falje për atë. Mirëpo sot myezini kryen ezanin dhe kalon një kohë e gjatë e në xhami nuk ka asnjë deri sa të fillojë namazi e pastaj vijnë përtacët.

Mosprania në namaz sa ç'humbet shpërblime të shumta, aq edhe hap derën e neglizhencës në namaz dhe në fund të tërheq deri në lënien e namazit me xhemat.

Transmeton Muslimi nga Ebu Seid, radijallahu anhu, se Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, pa në shokët e tij vonesën e namazit dhe u tha: *"Ecni përpara dhe më përcillni mua, ndërsa juve le t'ju përcjellin ata që keni mbrapa"*.

Ky hadith tregon rrezikun e vonimit të pranisë së namazit me xhemat dhe se i vonuari do të dënohet me vonimin e tij nga mëshira e Allahut... dhe mjafton që vonimi është ngjasim me hipokritët për të cilët Allahu në Kur'an thotë: **"Ata nuk e bëjnë ndryshe namazin, përveçse me përtaci"**, po ashtu thotë: **"...kur ata ngrihen për të falë namazin, ngrihen me përtaci"**.

Besoj se këtyre nëse u

Xhamitë e sotme janë bërë si të lëna pas dore, të mbyllura në shumicën e kohës, nuk hapet përpos se disa minuta, sa për t'u kryer namazi me shpejtësi.

Disa të tjerë, të cilët janë shumë, vijnë në xhami me përtaci dhe molisje dhe kalojnë një kohë të pakët me lodhje dhe mërzi, e shumë prej tyre kur dëgjojnë ikametin vijnë me shpejtësi dhe hyjnë në namaz jo të qetë.

kalon me vonesë ndonjë lakmi prej lakmive të kësaj bote do të ishin më të parët duke pritur orë të tëra pa u lodhur, e kjo ndodh për shkak se kjo botë është më e dashur për ata se ahireti (bota e amshuar).

Xhamitë e sotme janë bërë si të lëna pas dore, të mbyllura në shumicën e kohës, nuk

hapet përpos se disa minuta, sa për t'u kryer namazi me shpejtësi. Vërtet xhamitë kanë filluar të ankohen për atë se të paktë janë ata që i kanë marrë xhamitë shprehi dhe se ka humbur burrat që lavdërojnë Allahun në mëngjes dhe mbrëmje pa iu shmangur tregtia apo shitblerja nga përmendja e Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit. Vërtet xhamitë kanë humbur njerëzit që qëndrojnë në xhami (itikaf), që ndërtojnë xhamitë gjatë natës dhe ditës me ruku dhe sexhde. Më parë xhamitë kanë qenë shtëpi për ibadet, akademi, vendtakim i myslimanëve, aty janë njoftuar dhe janë bashkuar mes vetes, prej saj kanë përfituar përgatitje për ditën e gjykimit, dritën e besimit dhe bindje të fortë.

Zemrat e tyre kanë qenë të lidhura për xhamitë dhe ato kanë qenë më të dashura për ata se shtëpitë dhe pasuria e tyre, kanë qëndruar gjatë në të pa u lodhur, shkuarja e shpeshtë nuk ka qenë ngarkesë për ata, edhe nëse xhamia ka qenë në largësi, i kanë llogaritur hapat e tyre, kanë shfrytëzuar kohën e tyre dhe kanë nxituar që të shkonin sa më herët në xhami.

Kjo ka qenë gjendja e sele-

fit (myslimanëve të parë) me xhaminë, kurse sot është shtuar vonesa në xhami, është pakësuar të qëndruarit në të ku këtij umeti u kanë kaluar shumë të mira, është dobësuar pozita e xhamisë në zemrën e shumë prej njerëzve, është pakësuar ndikimi i saj dhe për këtë është paraqitur largësia, janë thyer zemrat, është shkëputur lidhja derisa fqinji nuk e njeh fqinjin e tij e as që di për gjendjen e tij.

O robërit e Allahut, kini frikë Atë dhe kthejani xhamive pozitën e tyre në zemrat tuaja, shkoni herët në xhami dhe shtojeni qëndrimin tuaj në të. Muhamedi salallahu alejhi ue selem, nxit për ecje në xhami dhe qëndrim në të ashtu që të përkujujtmë Allahun.

Ebu Hurejre radijallahu anhu rrëfen se Muhamedi salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Namazi i njeriut me xhemat shumëfishohet nga namazi që falet në shtëpi apo në treg për njëzet e pesë gradë, nëse ai merr abdes dhe e përsos abdesin e tij, pastaj del vetëm për ta falur namazin, për çdo hap që bën i ngrihet një gradë dhe i shlyhet një gabim, e kur të falë namazin, melekët vazhdimisht luten për të duke thënë o Allah mëshiroje, ai konsiderohet se është në namaz derisa është duke pritur namazin”*. Shënon Buhariu.

Shënon Maliku në Muveta: *“Kush merr abdes dhe e përkryen abdesin pastaj del qëllimisht për në namaz, ai është në namaz përderisa është në atë qëllim. Atij i regjistrohët për një hap një e mirë dhe i shlyhet një e keqe me hapin tjetër. Kur të dëgjojë ndonjëri prej jush ikametin, le të mos nxitojë sepse shpërblim më të madh ka ai që e ka shtëpinë më larg (nga*

xhamia). E pyetën: *përse o Ebu Hurejre? U përgjigj: për shkak hapave të shumtë.”*

Ebu Hurejre rrëfen se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë: *“A doni t’ju udhëzoj kah një vepër me të cilën Allahu i shlyen mëkatet dhe i ngre gradët? Thanë: si jo, o i Dërguari i Allahut. Tha: përkryerja e abdesit në vështirësi, hapat e shumta për në xhami dhe pritja prej namazit në namaz, kjo është qëndrueshmëria e vërtetë e xhihadit (e përsëriti dy herë)”*. Muslimi dhe Maliku.

Burejde rrëfen se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Ata që ecin në terr për të shkuar në xhami, përgëzoj me dritë të plotë ditën e Kijametit.”* (Shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu).

Ebu Hurejre rrëfen se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë: *“Vendet më të dashura tek Allahu janë xhamitë, kurse vendet më të urrejta tek Ai janë tregjet.”* (Muslimi)

Allahu i dha rëndësi çështjes së xhamive dhe i lavdëroi ata të cilët i ngjallin ato me adhurime. Atyre u premtoi shpërblime të mëdha. Allahu thotë: *“(ajo dritë) është në shtëpitë (xhamitë) që Allahu lejoi të ngrihen, e që në to të përmendet emri i Tij, t’i bëhet lutje Atij mëngjes e mbrëmje. Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për të falur namazin dhe për të dhënë zeqatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.”* (Nur: 36,37).

Përktheu: Bedri Lika

Shohim shumë prej tyre që jetojnë rreth xhamive e nuk hyjnë në të dhe as që dinë se çfarë ka brenda saj; janë përreth xhamive me shtëpitë e tyre, kurse me zemra janë larg tyre, e kjo aludon për besimin e tyre të dobët.

Mbi optimizmin, shpresën dhe gjendje të tjera

Shkruan: Edison ÇERAJ

Nuk mund ta them me siguri të plotë se, gjendja mbizotëruese në periferi është pasojë e një rastësie. Kryesisht, fjala është për rastësinë si fenomen dhe, specifikisht për rastësinë tashmë të mitizuar. Është me rëndësi të theksohet se çdo periferi i përket më shumë “harresës” se sa kujtesës; gjithnjë duke e parë kujtesën në kuadrin e një mikpritjeje, e cila mëton për një lidhje që sfidon rëndomtësitat e mërzitshme që, për “fat të keq” po shumohen zhurmshëm. Në njëfarë mase, dyshimi që shqetësonte banorët (ose të ftuarit) e këtij skaji, kishte pësuar njëfarë zhvendosjeje. Tashmë, orvatja është përqendruar për të vënë në dyshim qëllimin e përhapjes së dyshimit. Përse pra, nuk trokasim në derë, por e gërvishtim atë dhe ia mbatim pa lënë shenjë e nishan!? A nuk do të ishte më e fisme sikur fjala e parë të ishte një trokitje me ballë lart!? Dhe, këtu s’kemi të bëjmë me asnjë fije mendjemadhësie, e aq më pak me mburrje rrugicash, që, për nga ndikimi dhe jehona nuk zgjasin më shumë se sa perëndimi i diellit. Gjendja në të cilën mbizotëron dyshimi shpërhfaq faqe

botës shumë të vërteta të domosdoshme, që, medoemos duhet të dihen; por, nga ana tjetër, duke patur kujdes ngjyresat mitizuese. Po ashtu, kjo gjendje, është një ndihmesë shtesë për të zbuluar ku rrahin dhe çfarë ndjellin. Dyshimi mbi ekzistencën e dyshimit është një udhë jashtëzakonisht e errët. Sido qoftë, çdo masë errësire ka fundin e saj shpresëndjellës dhe po aq poetik për nga doza e mbresëmbetjes. Errësira

Natyrisht, çdo nismë që shoqërohet me vrull, edhe nëse bëhet fjalë për vrullin e mirëkontrolluar, ka nevojë për maturi dhe, që kjo maturi të japë atë çfarë njeriu pret, duhet gjetur një pikë e cila të mban në lidhje, pra një pikëmbështetje që luan rolin e vyer të përkujtuesit

nuk është frymëmarrja e Sizifit, madje ajo nuk e lejon hijen e tij të duket qoftë edhe një herë të vetme. Në fakt, shpresa për të tejkaluar një zonë të caktuar errësire, në thelb është më e fuqishme dhe më mbizotëruese se çdo errësirë, bile edhe sikur të gjitha errësitat të tubohen sëbashku. Shpresa nuk ka burim vështirësinë, por bëhet edhe më ngadhënjyese përbrenda kur shfaqet pas vështirësive dhe vuajtjeve që rrjedhin për shkak të një kuptimësie që përfaqëson njeriu. Përndryshe, vuajtja që bart një logikë njerëzore,

është njëfarë termometri, ose një lloj kuti që shenjon (nuk është e thënë që - ndonjëherë- të mos gabojë) të vërtetën e shpresuesit dhe, disa herë edhe arsyen



nxitëse. Obligmi i padokumentuar i shpresës (edhe pse në dukje krijon hamendësime) është tejkalimi, pra, thënë tjetërsoj, rendja drejt sigurisë që ajo premtion.

Natyrisht, çdo nismë që shoqërohet me vrull, edhe nëse bëhet fjalë për vrullin e mirëkontrolluar, ka nevojë për maturi dhe, që kjo maturi të japë atë çfarë njeriu pret, duhet gjetur një pikë e cila të mban në lidhje, pra një pikëmbështetje që luan rolin e vyer të përkujtuesit. Vetëm përkujtimi i herëpashershëm (*i endur me fijet e bardha të urtësisë*) ofron mundësinë e madhe për të mirëqartësuar dhe mirëforcuar synimin - ofron poashtu edhe shquarjen e pengesave që hasen në këtë rrugëtim-, pasi synimi është përcaktues i të gjithë veprimtarisë së njeriut. Në të vërtetë, duhen levizur të gjithë gurët që zotërojmë në mënyrë që synimi të mos mjerohet në *pabotën* e një synimi për hir të një synimi *tjetër*, ku nuk është paracaktuar ende asgjë, sepse, përtjetërsoj, puqen të gjitha konditat e shkarjes drejt një rrethi vicioz, ku dihet fare mirë që e gjithë përgatitja e mëparshme shumëzohet me

Përse pra, nuk trokasim në derë, por e gërvishtim atë dhe ia mbathim pa lënë shenjë e nishan!? A nuk do të ishte më e fisme sikur fjala e parë të ishte një trokitje me ballë lart!?

zero. Në pamje të parë, ekziston njëfarë frike për një rënie të mundshme në pesimizëm, por pa harruar asnjëherë se synimi për të cilin bëhet fjalë, nuk i nënshtrohet ligjit të asgjësimit, aq më pak atij të tkurrjes. Pikërisht, këtu gjendet ilaçi për rritjen e ambicies, për të arritur kështu një kuptim të qenësishëm të optimizmit; ngaqë, optimizmi nuk është iluzion që shfaqet vetëm në një ditë të dielë me diell, por është një realitet i njëmendët që shënon një dallim rrënjësor (duke përfutur ndjesitë/dëshmitë më sublime) mes njeriut dhe krijesave të tjera. Për fat të keq, është pikërisht ky dallim tejet i rëndësishëm, i cili është cënuar vrazhdë, -për të mos thënë është shkërmoqur- nga pseudohumanizmi i Modernizmit dhe i Pasmodernizmit. E pra, ky dallim, është një nga sfidat më paradoksale që është hasur ndonjëherë përgjatë historisë, dhe njëkohësisht është kërcënimi më i madh për njeriun bashkëkohor.

(Autori është As. Pedagog në Akademinë e Arteve në Tiranë
Deqa e Multimedia-s)



Çelësi i urtësisë

Said b. Alij EL-KAHTANI

Urtësia është dhuratë nga Allahu i madhëruar, ia dhuron kujt të dojë nga robërit dhe evlijave të Tij. Urtësia nuk mund të përfitohet pa mësimin dhe udhëheqjen e pejgamberëve. Robi nuk është i urtë, në rast se nuk i përcjell rrugët e përfitimit të urtësisë dhe po ashtu nuk mund ta përfitojë urtësinë në rast se nuk i ka nxjerrë mësimet nga Kur’ani dhe sunneti. Kur myslimani i futet rrugës së urtësisë, kjo nuk e nxjerr nga ajo që quhet dhuratë nga Allahu i madhëruar sipas thënies së Allahut: *“Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe, përveç të mençurve këtë nuk e kupton kush”* (Bekare 269). Çka do të thotë se Ai

është nderuar dhe i ka dhënë hair të madh me vlerë të madhe, me dobi të madhe.

Për këtë arsye, disa dijetarë, fjalët *“i është dhuruar mirësi e madhe”* i kanë shpjeguar se dhënia e urtësisë është hair i dynjasë dhe gjithë çfarë ka në të, duke u nisur nga fjalët me të cilat Allahu e ka përshkruar dynjanë: “mirësi e madhe”, çka tregon (argumenton) se, atë që e jep Allahu nga urtësia është më e mirë sesa dynjaja dhe çka ka në te, pasi ai të cilit i është dhënë ajo ka shpëtuar nga errësira e paditurisë dhe ka dalë në dritën e udhëzimit; nga devijimi në fjalë dhe vepra në goditjen e të vërtetës; në arritjen e drejtësisë dhe maturisë; në zgjuarsinë e ndriçuar. Kjo është nga dhëniet më të mira dhe dhu-

"Dhe mos ec nëpër tokë me mburrje, pse ti as nuk mund ta çash tokën as nuk mund ta arrish lartësinë e maleve. E keqja e të gjitha këtyre është e urryer te Zoti yt. Këto janë nga urtësia që Zoti yt ta shpalli ty. Mos shoqëro me Allahun ndonjë zot tjetër e të hidhesh në xhehenem i qortuar dhe i larguar."

ratat më të çmuara.

Urtësia ka rrugë me anë të cilave përfitohet me pëlqimin e Allahut të madhëruar. Nga rrugët më të rëndësishme, që, nëse i ndjekë myslimani, bëhet i urtë me lejen e Allahut të madhëruar, janë:

1 - Sjellja me urtësi

Urtësia shpërndahet sipas degëve. Njëra nga këto degë është sjellja me urtësi dhe përmbajtja e moralit të mirë; largimi nga gjërat e turpshme haptazi dhe fshehurazi.

Të gjitha këto i arrin:

- Duke u bërë shembulli më i mirë për të tjerët dhe atë me pasimin e prijesit tonë të urtë Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të. Allahu e ka lavdëruar me fjalët: *"Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!"* (Kalem 4.), çka ia dëshmoi edhe populli i vet, i cili e thërriste **"Es-Sadiku El-Emin"** - i drejti i besueshmi.

- Duke u bazuar në themelet e moralit të urtë.

Prej ajeteve që ngërthen këto themele mund të përmendim: **"Allahu urd-hëron drejtësi, bamirësi,**

"Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njo-huri, pse të dëgjuar-it, të parit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi."

ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të mer-rni mësim" (Nahël 90), sikundërse ajetet nga surja Isra.

- Besimi i pastër pa shirk. **"E mos shoqëro me Allahun ndonjë zot tjetër, e të bëhesh i qortuar i papërkrahur."**

- Mirësjellja me prindërit. **"Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrihe pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: "Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël".**

- Pendimi. **"Zoti juaj e di më së miri atë që keni në shpirtin tuaj. Nëse keni qëllime të mira, vërtet Ai u fal atyre që pendohen."**

- Mirësjellja me të afërmit, me të varfrit. **"Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfrit, edhe atij në rrugë, po mos shpenzo tepër e pa rrugë."**

- Shpenzimi i matur. **"Ata që shpen-zojnë tepër janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është për-buzës i madh i Zotit të Tij;"**; **"Nëse**

detyrohesh t'ua kthesh shpinën atyre (të afër-mve etj.), duke kërkuar mëshirën të cilën e shpreson nga Zoti yt (furnizim për t'i ndih-muar ata), atëherë thuaju atyre fjalë të mira (të lehta)."

- Bujaria dhe zemërbardhësia. *“Dhe mos e bëj dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bëj dorështrënguar), e as mos e shtrij në tërësi, e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt).”* Risku është nga Allahu: *“S’ka dyshim se Zoti yt*

është Ai që furnizon me bollëk atë që do dhe ia kufizon atij që do. Ai hollësisht e di për robërit e vet dhe i vështron.”

- Kujdesi për fëmijët. *“Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh.”*

- Nderi. *“Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.”*

- Ndalimi i vrasjes. *“Dhe mos e mbytni njeriun që Allahu e ka ndaluar (mbytjen e tij), përveç me drejtësi (që e kërkon sheriatin). E kush mbytet pa të drejtë (pa faj), kujdestarit të tij Ne i kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë), e ai të mos e kalojë kufirin në mbytje derisa ai është i ndihmuar (prej Zotit).”*

- Ndalimi i keqpërdorimit të pasurisë së tjetrit (jetimit). *“Mos përdoroni pasurinë e jetimit ndryshe vetëm në mënyrë më të mirë (për t’ia shtuar), derisa ai të arrijë pjekurinë e vet. Premtimin zbatojeni, sepse për premtimin ka përgjegjësi.”*

- Peshimi i saktë. *“Masën mbusheni kur matni (me enë) dhe peshoni me peshojë të drejtë (precize). Kjo është më e dobishme dhe ka përfundim më të mirë.”*

. “Ata që shpenzojnë tepër janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të Tij.”

- Ndalimi i të folurit pa dituri. *“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të parit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.”*

- Ndalimi nga mendjemadhësia. *“Dhe mos ec nëpër tokë me mburrje,*

pse ti as nuk mund ta çash tokën as nuk mund ta arrish lartësinë e maleve. E keqja e të gjitha këtyre është e urryer te Zoti yt. Këto janë nga urtësia që Zoti yt ta shpalli ty. Mos shoqëro me Allahun ndonjë zot tjetër e të hidhesh në xhehenem i qortuar dhe i larguar.” (Isra 22 – 39).

Siç shihet, këto ajete kanë përfshirë njëzetë e pesë urtësi. T’i përvetësosh dhe t’i zbatosh këto, është më e mirë se dynjaja dhe gjithë çfarë gjendet në të, ndërsa anashkalimi i tyre sjell humbje dhe disfatë në dynja dhe Ahiret.

Më në fund Allahu i lartmadhëruar këtë ajet, që mbaron me fjalët: *“... Këto janë nga urtësia që Zoti yt ta shpalli ty ...”* (Isra 39).

- Duke marrë mësim nga fjalët dhe veprat e të urtëve.

Një njeri takohet me Llukmanin, Allahu qoftë i kënaqur me të, dhe e pyet: A ti je Llukmani? Ti je Abdu Beni En-Nuhas? Tha: Po. Tha: A ti je bariu i deleve të zeza (d.m.th njerëzve)? Tha: Sa i përket të zezës time (d.m.th numrit të madh të njerëzve që e ndiqnin) është e dukshme, por çka është ajo që të pëlqen nga puna ime? (Ajo është): njerëzit po e shkelin tepihun tënd, po tubohen te dera jote dhe janë të kënaqur me fjalën tënde. Tha: o bir i vëllait tim, nëse ti vepron atë që të

them, do të bëhesh si ata. Tha: Çka është ajo? Llukmani tha: unë e përul shikimin, e mbledh gjuhën, i përmbahem ushqimit, e ruaj nderin, i kryej obligimet, e përmbush zotimin, e gostis mysafirin, e ruaj fqinjin dhe e braktis atë që nuk ka të bëj me mua, pra e gjithë kjo më ka bërë kështu siç po më sheh. (El-bidaje ve en-nihaje).

2 - Të vepruarit me dituri dhe sinqeritet.

Kjo është nga rrugët më të rëndësishme të urtësisë. Dituri është ajo që bazohet në argument. E dobishmja është nga Kur'ani dhe Sunneti, duke mësuar fillimisht kuptimin e tyre dhe, pastaj, të vepruarit sipas tyre. Nëse njeriu nuk e ka këtë qëllim, nuk mund të jetë ndjekës i dijes dhe i Fesë.

3 - Të përqendruarit.

Allahu i madhëruar ka thënë: *“E, s’ka dyshim se ata që thanë: ‘Allahu është Zoti ynë’, dhe ishin të paluhatshëm, atyre u vijnë engjëjt (në prag të vdekjes dhe u thonë): të mos u frikësoheni, të mos pikëlloheni, keni myzhde xhenetin që u premtohej”* (Fusilet 30).

Sufjan b. Abdullah rrëfen: I thashë pejgamberit - salallahu alejhi ue selem: *O i dërguari i Allahut, ma thuaj mua një fjalë në islam që mos të pyes për të askënd tjetër. Tha: Thuaj Besova në Allahun e pastaj përqendrohu.* (Muslimi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe, Ahmedi).

4 - Përvoja.

Allahu i madhëruar ka thënë: *“Ne do t’ua bëjmë atyre të mundshme që t’i shohin argumentet Tona në horizontet dhe në veten e tyre deri që t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i*

vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë” (Nahël 53).

Nga Muaviju mësojmë se Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Nuk ka të urtë, përpos atij që është me përvojë”* (Buhariu 10, 529). Po ashtu, i dërguari, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Besimtari nuk kafshohet nga e njëjta strofull dy herë”* (Buhariu, Muslimi).

5 - Udhëheqja me urtësi

Dhe atë:

- Duke i shfrytëzuar kohët e lira me aktivitete. Abdullah b. Mesudi i ka këshilluar njerëzit në çdo të enjte. Një njeri i tha: *“O Ebu Abdur-Rahman, dëshiroja që të na këshilloje çdo ditë. Tha: Sa më përket mua, më ndalon droja se mos ju mërzis, andaj edhe ju këshilloj rrallë, ashtu siç bënte Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, i cili na këshillonte rrallë nga droja se mos na mërziste”.* (Buhariu, Muslimi).

-Duke pasur parasysh situatën e parisë në gjendjen që jetojmë. Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, i ka thënë Aishes: *“Oj Aisha po të mos ish populli yt i ri (në islam) me xhahilet, do të kisha urdhëruar të rrafshohej Qabeja, e të shtyja aty, atë që e kanë nxjerrë, do ta bashkoja me tokën, do t’i bëja dy dyer: derë nga lindja dhe derë nga perëndimi dhe do t’i përfshija themelet i Ibrahimit”* (Buhari, Muslim)

-Duke i fituar zemrat e njerëzve me shpërndarje të pasurisë. Allahu e ka krijuar njeriun që të jetë lakmues për nga natyra. Nga zekati ka caktuar hise që u takon atyre që duam t’u fitojmë Zemrën.

Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Unë i jap ndonjë njeriu, por tjetri ndoshta është më i dashur tek unë...”* (Buhariu, Muslimi). Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë edhe këtë: *“jepni dhuratë që të duheni mes jush”* (Buhariu, Muslimi).

-Duke ua përmendur meritat të tjerëve pa e tepruar. Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, kur ka dashur të tregojë për Ensarët se janë të dashur tek ai, u ka thënë: *“...po të ecin njerëzit kah ndonjë luginë, apo rrugë, do të shkoja (zgjedhja) luginën e Ensarëve apo rrugën e Ensarëve”*. (Buhariu, Muslimi).

Në politikën islame nuk ka gënjeshtër dhe mashtrime, por thuhet e vërteta.

-Fitimi i zemrave duke falur gabimin. *“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falja atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që mbështeten”* (Ali Imran, 159).

Pra, këto janë disa rrugë dhe shkaqe me anë të cilave me lejen e Allahut mund të arrihet urtësia.

Marrë nga

“El-hikmetu fi daveti ila Allah”
përktheu: Ali Shaban Tanusha

Tipologjitë metodologjike të Ehli Sunetit në marrëdhëniet me myslimanë

Dr. Sefer EL-HAVALI

Korrektësia ndaj kundërshtarit dhe bashkëmendimtarit është diçka vërtet shumë madhështore, e këtë s’e bën askush në formë më të arrirë sesa ehli sunneti, i cili i nënshtrohet fjalës që Allahu xhele sha’nuhu shpreh në librin e Tij: **“Thuaj: Allahu më urdhëroi mua drejtësinë”**. (El Araf 29) dhe fjalës së të Dërguarit të Tij: **“Kush falë namazin tonë, drejtohet nga kibra jonë dhe ha ushqimin tonë (atë që ne themi), ai është mysliman që ka garancinë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, e mos e thyeni (ose prishni) garancinë e Allahut”**.⁽¹⁾

Shumë prej njerëzve të sinqertë, pas gëzimit të thellë nga thirrja për rikthim të umetit islam, fillojnë që të ndihen disi të pasigurt përsa i përket mundësisë së arritjes së unitetit të duhur nën hije të grupimeve ekzistuese; e megjithatë,



nëse rrahim t'i japim zgjidhje këtij problemi, nuk kemi alternativë tjetër përpos se të kapemi fort pas shkollave dhe traditës që u formuan qysh se në kohën e kalifëve të drejtë dhe gjeneratave tjera të ndershme pas tyre. Kalifët e drejtë dhe gjeneratat e mira pas tyre arritën të lëvronin një traditë të mirëfilltë dhe të përvetësuarin tipologjitë e duhura e të sakta metodologjike qoftë përsa i përket sjelljes, qoftë përsa i përket marrëdhënieve dhe bashkëveprimit me muslimanët; madje, përmes këtij gjerdani të saktë dhe të mirëfilltë të tipologjive metodologjike, që përfshin një varg metodash dhe formash sa të të vepruarit, po

aq edhe të të kuptuarit drejt, ata arritën të siguronin dhe të ruanin të pacenuar unitetin e umetit dhe forcën që buronte nga bashkimi i tij.

asnjëherë nuk i përshkruajnë vetes përsosmëri, nuk e lavdërojnë vetveten me moto dhe emërtime të ndryshme. Për të argumentuar ndjekjen e tyre, nuk mjaftohen vetëm me deklarinimin se i përkasin rrugës së drejtë, përkundrazi, janë të bindur se shpëtimi nuk arrihet me shpresa

S'ka dyshim se këto tipologji metodologjike, që u shpalosën të suksesshme në rregullimin e gjendjes së umetit në të kaluarën, janë në gjendje që ta luajnë këtë rol edhe në kohët tona. Çka nënkupton shprehimisht se uniteti dhe rikthimi i umetit në themelet e traditës së dikurshme është një nga obligimet e thirrësve. Ky unitet dhe rikthim i umetit në traditën e dikurshme lidhet drejtpërsëdrejti me marrëdhëniet që lipset të

ngërthejmë me krijesat, sidomos me ithtarët e kibles (myslimanët), sipas formave dhe qëndrimeve të diktuar nga veçoritë e tipologjive në fjalë.

Duke analizuar argumentet e sheriatit (legjislacionit islam) dhe rrugët e imamëve të fesë nga ehli sunneti na bëhen të qarta veçoritë më të rëndësishme të mbarë asaj larushie dinamike metodash e formash qëndrimi dhe sjelljeje që diktohen nga tipologjitë metodologjike që lëvroi ehli sunneti, siç janë:

1- Ehli sunneti është i vetëdijshëm për faktin se, pas udhëzimit në besim, dhurata më e madhe që mund t'i bëhet njerëzve është udhëheqja e tyre në besim nga ata që vënë në jetë me përpikëri parimet dhe të vërtetat e sunnetit, dhe jo nga syresh që jepen pas epsheve apo pas trillimeve të turlillojshme në fe (bidatxhinjtë). Duke qëndruar në këto parametra, njerëzit e udhëhequr në besim do të gjejnë, përvetësojnë dhe jetojnë sipas gjithë sa është e drejtë dhe e vërtetë, do të vjelin frytet e dëshiruara dhe shpëtimin e nevojshëm, çka do t'i shtyjë të kuptojnë qartë se si kjo udhëheqje përbën në të vërtetë një dhuratë (begati) të paçmuar, ndaj të cilës do t'i jenë mirënjohës Allahut të Lartësuar, do t'i jenë falënderues për të dhe ta lavdërojnë me tërë forcën e shpirtit. Pranimi i kësaj dhurate dhe falënderimi për të nënkupton vetvetiu të qenit i vetëdijshëm për vlerën e saj të paçmuar dhe shpëtimtare, çka do t'i shtyjë drejt vigjilencës, që të mos e humbasin për shkak të mëkateve

Drejtesia tek ata është vlerë absolute. Allahu ua vë çdonjërit drejtësinë detyrë dhe obligim në çfarëdo situatë.

Ajo është vlerë absolute që nuk e lëkund as dallimi në fe, as diçka më e vogël se ajo.

apo të neglizhencës karshi shkaqeve që shpijnë vazhdimisht në mëkat.

Nisur nga mirësia e pafundme karshi besimtarëve të Tij, Allahu e bëri sunnetin ngadhënjyes, ndërsa bidatin dhe mendimet tjera të kota, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen, i flaku tutje si të pavlera. Mirëpo shejtani i mallkuar, pavarësisht se nuk ka shpresë se do të

adhurohet nga ky umet, rreh që të mbjellë përçarje mes njerëzve, duke u përpjekur të vjelë kënaqësi prej grindjeve që zënë vend mes tyre.

2- Rruga e sunnetit dhe ndjekja e saj nuk është vetëm më udhëzuese dhe më e drejtë, por edhe më e gjerë dhe më e mëshirshme. Kjo ishte rruga që pranuan myslimanët e parë, nga muhaxhirët, ensarët, madje edhe nga myslimanët e tjerë arabë, siç ishin beduinët e shkretëtirës. Kështu që, ndjekësit e kësaj rruge janë të parët që meritojnë të jenë pjesë e këtij umeti të zgjedhur. ***"Pastaj Ne u lamë në trashëgim librin robërve Tanë që ne i kemi zgjedhur; e prej tyre ka që janë dëmtues të vetvetes, ka që janë mesatarë, e ka prej tyre që janë me ndihmën e Allahut, të parë në punë të mira, e kjo është mirësia e madhe"*** (Fatir 32).

Njeriu që shfaq mangësia nuk duhet ta humbasë shpresën, nëse qëndron më mbrapa sesa ata që janë më të përparuar në kryerjen e punëve të mira, pasi me ndihmën e këtyre të fundit, herët a vonë do të kenë jo pak mundësi që të përmirësohen dhe së bashku do të arrijnë suksesin e dëshiruar. Ka prej tyre që do

të hyjnë në xhenet nga tetë dyert, ka që do të hyjnë vetëm nga njëra derë dhe, së fundmi, ka syresh që do të jenë mes asaj. Prej tyre, ka që do të hyjnë në xhenet me Pejgamberët, sikundërse ka nga ata që do të hyjnë në xhenet për një “LA ILAHE IL-ALLAH” të thënë në ndonjë moment me plot sinqeritet, ose me një dinar që e lëshon në dorën e ndonjë nevojtari apo të varfëri, ose me largimin e ndonjë pengese nga rruga e myslimanëve (kalimtarëve).

3- Ata janë të ndryshëm në dhuntitë dhe në grada, porse të njëjtë në metodologji dhe në qëllim. Ka prej tyre që janë muxhahidë, urdhërues në të mirë dhe ndalues nga e keqja, mufessirë, muhaddithë, gjuhëtarë, poetë, e prej tyre ka njerëz të thjeshtë, që respektojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, edhe pse nuk kanë dituri për të dhënë.

Çdo njeri që mbart një natyrshmëri (fitren) të pa njollosur nga bidatxhinjtë, është pjesëtar i ehli sunnetit, njëlloj siç është foshnja e porsalindur në natyrshmërinë islame, përderisa prindërit e saj nuk e bëjnë çifut, të krishterë apo idhujtar.

4- Ehli sunneti i kryen obligimet që ka ndaj umetit ashtu siç e kërkon sheriat (legjislacioni islam).

Sheriat, në pjesën e marrëdhënieve me Allahun dhe kryerjen e obligimeve ndaj Tij, krijoi me të vërtetë hyrjen në Xhenet dhe shpëtimin me emrin Iman, kurse në pjesën që ka të bëjë me marrëdhëniet ndërnjerëzore, formuloi të drejtat

Sakaq, kjo nuk është pengesë që, ai që ka rënë në bidate, apo që bën mëkate, të mos rreshtohet në mbrojtje të Islamit apo në luftë kundër armiqve të tij.

Përkundrazi, ne duhet të përpiqemi t'i drejtojmë/përmirësojmë këta.

për ruajtjen e gjakut, pasurisë dhe nderit me emrin Islam. I Dërguari i Allahut, shpëtimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “Çdo mysliman e ka të ndaluar gjakun, pasurinë, dhe nderin e myslimanit tjetër”⁽²⁾, “Obligimet e myslimanëve ndaj njëri-tjetrit janë gjashtë”⁽³⁾, po ashtu thotë: “Mysliman është ai, prej gjuhës dhe dorës së të cilit myslimanët janë të qetë”⁽⁴⁾

Atij që i konfirmohet emri islam i konfirmohen edhe këto të drejta dhe nuk i merren pos me argument dhe për interes të fesë, madje, Allahu i quajti dy grupet që luftonin njëra-tjetrën besimtarë, për të bërë kësaj me dije konfirmimin e të drejtave mes myslimanëve. Allahu xhele shanuhu thotë: “**S’ka dyshim se myslimanët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj**” (El Huxhurat 10).

5- Ata nuk i anashkalojnë dispozitat themelore dhe rregullat e përgjithshme për shkak të dispozitave relative dhe situatave të caktuara. Nga rregullat e përgjithshme dhe themelore, që janë plotësisht të qartësuara nga ajetet dhe hadithet e vërteta, myslimanëve u shtrohet si detyrë që të jenë të bashkuar,

ndërsa nga dispozitat relative u shtrohet si detyrë që të qëndrojnë sa më larg bidatxhinjëve dhe mëkatarëve. Përderisa në këtë të dytën, nuk ka dobi të sigurt, atëherë nuk veprohet sipas saj. Madje, kjo është nga gjërat, ku situatat ndryshojnë dhe lidhur me to, pranohet më shumë se një mendim.

6- Kush fal namazin, drejtohet kah kibla dhe ha ushqimin e tyre (që ata therin), ai është një prej tyre,

gëzon të drejta të njëjta dhe i nënshtrohet të njëjtave detyrime, duke e patur llogarinë para Allahut xhele shanuhu dhe përfundimin tek Ai. Jo hulumtim në zemra, jo zbulim të fshehtësive, jo mendim të keq për besimtarët, jo ndarje mes myslimanëve me nofka dhe emra, qofshin ato edhe emrat më të ndershëm, si "Muhaxhir dhe Ensarë". Këto emra përdoren vetëm me qëllim lavdërimi, dallimi apo njoftimi. Nuk u bëri dobi mu'tezilive emërtimi i vetvetes me **"Bartës të tevhidit dhe drejtësisë"**, dhe nuk u bëri dobi sufive emërtimi i vetvetes me **"Evlijatë dhe të afërmit e Allahut"**. Madje, para tyre çifutët dhe të krishterët thanë: **"Ne jemi bijtë e Zotit dhe të dashurit e Tij"**.

7- Provokimin e njerëzve, që miqësojnë apo armiqësojnë aksh grupim apo person, ata e konsiderojnë nga bidatet (risitë) për të cilat na qortoi selefi (të parët tanë), ngase miqësia dhe armiqësia ndërtohet në bazë të vlerave të vërteta, dhe jo në bazë të emërtimeve. Xhemati i tyre i vogël është një shembull për xhematin e madh. Sikundërse është obligim të falurit në formën si është falur i Dërguari i Allahut dhe kalifet e tij të drejtë, dhe imami i tyre të jetë nga ndjekësit e sunnetit, duke mos ia ndaluar hyrjen në xhami hipokritëve dhe mëkatarëve që të falen bashkë me ehli sunnetin, edhe tubimi i tyre në bazë të sunnetit, në kuptimin e tij më të gjerë dhe më të thellë, është gjithashtu obligim. Sakaq, kjo nuk është pengesë që, ai që ka rënë në bidate, apo që bën mëkate, të mos rreshtohet në mbrojtje të Islamit apo në luftë kundër armiqve të tij. Përkundrazi, ne duhet të përpiqemi t'i drejtojmë/përmirësojmë këta në të

njëjtën mënyrë që imami i xhamisë i mëson xhematit mënyrën e drejtë të të falurit, dhe kjo është shumë më mirë dhe më e dobishme sesa ndarja e tyre në xhami të posaçme me imamin e tyre, gjë e cila do të sillte armiqësi mes dy xhamive apo xhematëve.

8- Ata janë të fuqishëm në të vërtetën, por pa ekstremizëm, janë të mëshirshëm ndaj krijesave e jo tiranë, urdhërojnë në të mirë me të mirë dhe ndalojnë nga e keqja pa të keqe.

9- Ata janë të drejtë në gjykim dhe nuk ua dëmtojnë njerëzve gjërat që u përkasin. I vlerësojnë gjërat me drejtësi dhe urtësi, prej dy dëmeve zgjedhin më të voglin e prej dy të këqijave largohen nga më e madhja dhe nga dy çështjet zgjedhin më të lehtë. Në drejtësinë e tyre kërkon strehim i dobëti prej çdo umeti dhe grupi dhe beson në diturinë e tyre kërkuesi i të vërtetës prej çdo populli, feje apo sekti.

Drejtësia tek ata është vlerë absolute. Allahu ua vë çdonjërit drejtësinë detyrë dhe obligim në çfarëdo situatë. Ajo është vlerë absolute që nuk e lëkund as dallimi në fe, as diçka më e vogël se ajo. Allahu i madhëruar thotë: **"Urrejtja ndaj një populli që iu pat penguar nga xhamia e shenjtë të mos ju shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre"**. (Maide 2)

Çdo njëri që s'e di dallimin mes obligimit të armiqësisë ndaj jobesimtarëve e të padrejtëve dhe obligimit të drejtësisë ndaj tyre, e që nuk di t'i praktikojë këto dy obligime në mënyrë paralele, nuk është prej atyre që kanë kup-tuar sheriatin dhe nuk është ndjekës i zotërisë të Pejgamberëve, Muhamedit salAllahu alejhi ve selem, të cilit Allahu në shpalljen e Tij i tha: **"Jam urdhëruar**

Allahu e bëri sunnetin ngadhënjyes, ndërsa bidatin dhe mendimet tjera të kota, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen, i flaku tutje si të pavlera. Mirëpo shejtani i mallkuar, pavarësisht se nuk ka shpresë se do të adhurohet nga ky umet, rreh që të mbjellë përçarje mes njerëzve

të mbaj drejtësi mes jush” (Esh Shura 15). Ibën Kajimi në “Nunije” gjatë tregimit të tij për davetin e pejgamberëve thotë: “Gjithashtu pohojmë se ata erdhën me drejtësinë e Allahut në mesin e grupeve njerëzore”.

10- Nga urtësia e tyre në thirrje (dave) është: shfaqja e cilësive dhe punëve të mira të imamëve të pasuar, imamëve të diturisë, moralit dhe thirrjes, duke sqaruar se arritjet e tyre madhështore janë rezultat i ndjekjes të së vërtetës dhe luftës së tyre për shkak të saj. Po ashtu, suksesi që ata kanë arritur në fushën e davetit është rezultat i ndjekjes hap pas hapi të sunnetit të Pejgamberit alejhi selam. E gjithë kjo duhet shfrytëzuar si një mjet për thirrjen e ndjekësve, apo të atyre që rrahin të bëhen pjesë e ehli sunnetit, ndërkohë që, nga ana tjetër, duhet të qëndrojmë larg nga ndjekja fanatike i imamëve dhe duhet punuar në ndihmë të fesë ashtu siç ndihmuan imamët. Nga kjo këndpërqasje, drejtësia ndaj imamëve që ndjekim përkon thellësisht me thirrjen (davetit) me urtësi të ndjekësve, njëlloj siç veproi shejhul islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, gjatë fjalimit të tij në lidhje me katër imamët e njohur, dhe tjerë si Esharir

¹³ A'rafë

dhe Adij b. Musafir.

11- Ata e përulin veten para Allahut më shumë se kushdo tjetër dhe asnjëherë nuk i përshkruajnë vetes përsosmëri, nuk e lavdërojnë vetveten me moto dhe emërtime të ndryshme. Për të argumentuar ndjekjen e tyre, nuk mjaftohen vetëm me deklarimin se i përkasin rrugës së drejtë, përkundrazi, janë të bindur se shpëtimi nuk arrihet me shpresa, siç nuk shpëtuan me shpresa edhe ithtarët e librave.

12- Në xhihadin e tyre, në thirrjen, në urdhërimin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja, në ashpërsinë që tregojnë ndaj bidatxhinjve, si dhe në çështjet tjera, ata marrin hov ose ngurrojnë varësisht nga argumenti Fetar, nga interesi apo pesha që shfaq një çështje nga pikëpamja Fetare. Këta janë njerëz që s'kanë tjetër më të dashur sesa Allahun, të Dërguarin e Tij apo besimtarët, dhe nuk priren asnjëherë nga hakmarrja, nga shfryrjet apo arritjet për të fituar famë; të tillë njerëz janë në gjendje të qortojnë ashpër mikun më të afërt dhe të falin armikut më të betuar, nëse një gjë e tillë kërkohet nga urdhri i Allahut, Resulullahit, salAllahu alejhi ue selem, apo sepse një gjë e tillë gjykohet t'i sjellë dobi Islamit.

13- Ata gëzohen për pendimin e njerëzve, pranojnë arsyetimin e gabimtarit dhe luten për udhëzimin e mëkatarit, sepse asgjë nga këto nuk është personale, por vetëm dëshirojnë kënaqësinë e Allahut xhele shanuhu. Ata kujdesen për udhëzimin e krijesave dhe nuk dëshirojnë që të hasin ndonjë risi apo mëkat nga kundërshtarët. Kushdo që gëzohet me një gjë të tillë i gëzohet mëkatit ndaj Allahut xhele shanuhu e kush gëzohet në kësi qëndrime ai s'ka çfarë të shpresojë tek Allahu. Më pas,

njerëz të tillë tregohen zemërgjerë përpara dobësive apo pakujdesive që mund të shfaqin myslimanët, nuk i zbulojnë turpet e tyre dhe nuk i përmendin gabimet e dijetarëve përpos me qëllim të sqarimit të së vërtetës dhe të përcaktimit të mendimit të saktë, dhe kurrësi me qëllim të kritikës, madje, kërkojnë dhe arsyetimin për ta, për aq sa një gjë e

tillë shfaqet e mundshme. Ndër radhët e selefëve (të parët e mirë) kishte syresh që i këshillonin imamët dhe hatibat që të mos hynin në detajet e mëkateve të myslimanëve, sepse kështu bëjnë publikimin e të metave në foltore, çka do t'i gëzonte të krishterët dhe çifutët. E njëjta vlen edhe për trysnitë e xhematëve islame ndërmjet vete, në mjediset e kufrit dhe bidatit.

14- Ata e dinë se shumica e njerëzve e përkufizojnë sunnijun (ndjekësin e sunnetit) si njeri që është i pastër në sunnet, që nuk bën gabime, keqinterpretime (te'vil) apo vepra nga padituria; nga ana tjetër, disa të tjerë mendojnë se bidatxhi është një njeri tek i cili janë bashkuar bazat e bidatit, apo që i përket një grupi që gjykohet tërësisht si i devijuar. Por, e vërteta është se bidati është si të gjitha mëkatet: ka bidate të mëdha dhe të vogla, të qarta e të dyshimta, e mundësia për të mos rënë në te është e rrallë ose e vogël.

15- Ata e dinë se kundërshtimi me anë të keqinterpretimit (te'vil), gabimit dhe paditurisë është cilësi e shumicës së krijesave. Ndodh që te një njeri apo te një grup të bashkohen kujdesi i madh ndaj

S'ka dyshim se këto tipologji metodologjike, që u shpalosën të suksesshme në rregullimin e gjendjes së umetit në të kaluarën, janë në gjendje që ta luajnë këtë rol edhe në kohët tona.

sunnetit dhe rënia në bidat, sikundërse ndodh që bidatxhinjtë në disa raste dhe vende të veprojnë në përputhshmëri me sunnetin. Pra, vlerësimet bëhen në përgjithësi në bazë të rregullave thelbësore dhe metodologjisë së drejtë dhe të saktë (menhexhit), dhe suksesin e korr vetëm ai të cilit Allahu i jep sukses.

16- Ata e kuptojnë se gjithsecili e ka për detyrë që të ndreqë vetveten, të nxjerrë në pah dhe të punojë për largimin e të metave, të ripërtërijë besimin, të japë apo të marrë këshilla me të tjerët, pa ashpërsi dhe pa kaluar në fyerje, dhe të pranojë të vërtetën si të tillë, pa marrë parasysh se nga kush vjen.

17- Kërkimi i përsosmërisë nuk i pengon ata nga urtësia në sjellje, duke iu përshtatur gjendjes reale; ata thërrasin në të vërtetën e plotë pa të meta, në ndjekje të plotë të Dërguarit, shpëtimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, duke qenë të vetëdijshëm ndaj faktit që njerëzit këto gjëra t'i pranojnë gradualisht; madje, ata janë po aq të vetëdijshëm edhe për faktin tjetër se, në praninë mund të ketë dallime të rastit. Jeta e Pejgamberit, shpëtimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, është metodologjia dhe shembulli që ndjekin gjatë tërë punës së tyre.

18- Ata janë të bindur se ai që ka pak dituri dhe është dritëshkurtër sa i përket kapjes së fortë për sunnetin dhe në anën tjetër të sjelljes Fetare me umetin, veçanërisht me ata që nuk pajtohen në çështje të caktuara, ai vetëm se ka dështuar në ndjekjen e të Dërguarit alejhi

salatu ue salam dhe sunnetit, si shembulli i atij që mendon se kundërshtari privohet nga çdo e drejtë që i takon fetarisht, se drejtësia ndaj tyre është dobësi dhe pavramendje, apo se feja nuk ndihmohet përpos se me njerëz të përukur dhe të nënshtruar plotësisht dhe me ndjekje të përkryer. Në të vërtetë, Allahu xhele shanuhu e ndihmon këtë fe edhe me njeriun mëkatar e të pamoralshëm dhe me njerëz që nuk kanë ndonjë vlerë, sidomos gjatë ballafaqimeve, qofshin ato luftarake, ideologjike apo politike. Për këtë arsye, baza e sunnetit është: **“Xhihadi me çdo të mirë dhe të keq”**, e ky xhihad ngërthen xhihadin në fushë të betejës, xhihadin politik, xhihadin në dituri dhe atë në thirrje (davet), përderisa qëllimi i tij është mposhtja e armikut të hapur ndaj fesë, i cili, po të na sundonte, do të sillte dëme më të mëdha sesa dëmet që mund të shkaktonte sundimi i atij të cilit i mungojnë kushtet e drejtësisë dhe të Udhëzimit. Shumë dijetarë nga selefët luftuan në ushtrinë e Haxhaxh b. Jusufit duke mos dyshuar askush prej tyre në tiraninë dhe padrejtësinë e tij, madje, ehli sunneti u gëzuan për atë që bënë disa prej kalifëve me bidatxhinjtë, edhe pse ata vetë nuk ishin në sunnetin e pastër, sikurse Mutevekili dhe Halid b. Abdullah el-Kuseriju. Pra, me rëndësi në gjithë këtë është të ndihmohet feja dhe aplikimi i ligjit të Allahut.

19- Duke marrë parasysh situatën politike të botës islame, mund të pohojmë se:

a) Duhet bërë dallim mes

atij që thërret në Kur'an dhe sunnet në formë të përgjithshme, por ka rënë në bidat ose në mendim të devijuar dhe atij që thërret në bidatin e tij apo në mendimin e devijuar. Të dy këto grupe i hasim në përlëshjet politike, sepse disa njerëz e morën bidatin si parti politike e disa tjerë i përkasin bidatit në thelb, mirëpo këta i kundërshtojnë të parët dhe thërrasin në islam në formë të përgjithshme, çka e bëjnë në mënyrë të pavarur ose nën flamurin e përgjithshëm islam.

Ndërsa ka të tjerë që janë në drejtim të devijuar, si komunizmi, nacionalizmi, shekullarizmi, mandej udhëzohet në formë të përgjithshme, por duke mos ditur detajet e shpalljes së Allahut. Në këtë rast, është obligim të bëhet dallimi mes këtij dhe atij që akoma është në komunizëm, shekullarizëm, nacionalizëm etj.

Historia islame dëshmon se Allahu i lartësuar ndihmoi islamin kundër armiqve kryqtarë, batinij, mongolë etj. me njerëz që s'ishin në sunnetin e pastër, i ndihmoi ngase ata luftonin të ngadhënjente islami e jo të përhapeshin bidatet. Prandaj, ka dallim mes tyre dhe shteteve të havarixhëve, të rafidive (shiave) batinijve etj., të cilët u ngritën në lindje dhe në perëndim të botës islame dhe i luftuan myslimanët me qëllim që t'i fusnin në bidatin e tyre.

Partitë islamike në botë, kur ballafaqohen me rafiditë (shiat), shekullaristët, nacionalistët apo komunistët në betejat luftarake apo politike, që janë gjithaq të shkimta, është

Jo hulumtim në zemra, jo zbulim të fshehtësive, jo mendim të keq për besimtarët, jo ndarje mes myslimanëve me nofka dhe emra, qofshin ato edhe emrat më të ndershëm, si "Muhaxhir dhe Ensarë".

vaxhib (obligim) t'u ndihmohet kundër partive të bidatit dhe kufrit, sikurse është obligim këshillimi i tyre të udhëzohen në sunnetin e pastër. Bërja e këtyre dy gjërave nuk paraqet askurrfarë problemi për ata që kanë kuptim dhe dije mbi këtë Fe. Ndërsa, angazhimi me armiqësi ndaj këtyre duke anashkaluar armiqësinë ndaj bidatxhinjve dhe mosbesimtarëve është gabim i madh, e gabim edhe më i madh është miqësimi me ata që nuk gjykojnë me ligjin e Allahut dhe armiqësimi me partitë islame, gjë që nuk e bën kush pos mynafikut të shfaqur apo atij të verbët, që s'ka as kuptim as mendim. Ky i ngjan atij që fillon të ndërtojë një kishë duke mbyllur xhaminë me arsytet se xhematlinjtë (falësit) nuk falen sipas sunnetit, ose i thërret njerëzit të hanë cofëtinën dhe ta lënë atë që kanë therë mëkatarët, ose merr abdes me ujë të papastër duke lënë ujin për pastërtinë e të cilit ka dyshim.

b) Ndjekësit e sunnetit kanë për detyrë të kenë kujdes nga historia e havarixhëve dhe metodologjisë së tyre në sjellje, ata vranë Abdullah b. Hababin, radijAllahu anhu, duke e konsideruar hallall derdhjen e gjakut të tij, ndërkohë që kursyen një të krishterë për shkak të garancisë që kish! Luftonin myslimanët e kursenin idhujtarët. Prej tyre nuk shpëtuan shumë nga shokët e të Dërguarit alejhi salatu ue selam, pasardhësit e tyre të mirë si dhe imamët e diturisë e besimit. Këtij lloji të njerëzve nuk do t'i bëjë dobi pretendimi se ata janë të vetmit ehlu sunne uel xhema'a dhe të udhëzuar. Vërtetë kjo është nga shkaqet më të mëdha të përqendrimit në epsh dhe verbërimin të zemrës për të mos pranuar hakun. Nga Allahu kërko-

jmë shpëtimin dhe shëndetin.

c) Në të vërtetë, sjellja korrekte ndaj myslimanëve është rruga më e sigurt për bashkimin e umetit, ngase ajo bazohet në rregullat fetare që kanë mbështetjen në tekstet e shpalljes dhe jo thjesht në interes, siç mendojnë shumë njerëz. Sqarimi i këtyre rregullave është pjesë nga metodologjia e ehli sunnetit; umeti nuk mund të bashkohet dhe as të fitojë përveçse në rastet kur qëndron i kapur fort pas metodologjisë së ehli sunnetit.

d) Sakaq, s'duhet të harrojmë se armiqët e Allahut na ngrenë kurthe nga më të këqijat, ata kanë vendosur që beteja e ardhshme të jetë vendimtare për ngadhënjimin e tyre. Është obligim i gjithë myslimanëve të qëndrojnë të bashkuar në këtë xhihad të madh dhe të refuzojnë nënshtrimin dhe dorëzimin para armiqve të Allahut. Të përgatiten në çdo aspekt për ballafaqim me ta në çdo fushë, ndërsa përgatitja më e madhe pas devotshmërisë është bashkimi, e kjo në vete është fitore e madhe, siç thotë Allahu i Madhëruar: ***"Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij të rreshtuar sikur të ishin ndërtesë e fortifikuar."*** (Saf 4)

U plotësua qëllimi. E në duart e Allahut është suksesi.

⁽¹⁾ Sahihul Buhariu (2 /150)

⁽²⁾ Sahihul Muslim me koment të Neveviut (12/426)

⁽³⁾ Sahihul Muslim me koment të Neveviut (11/127)

⁽⁴⁾ Sahihul Buhariu (1/15)

Përktheu: Ismet SHERIFI

Operacionet plastike



Shkruan: Alaudin ABAZI

Koha në të cilën jetojmë na shtyn që të përballemi me një dinamikë të risive, që bartin me vete një numër të madh ndryshimesh në etikë dhe në mënyrën e jetesës. Shumë zbulime që njerëzit i konsideronin si të pamundura, para se të zbuloheshin, sot janë kthyer pjesë e rutinës së përditshme për secilin. Dinamika e ndryshimeve vërehet në të gjitha fushat; shkenca bashkëkohore zhvillohet dhe hedh hapa gjigante. Andaj dhe dilemat para nesh janë të shumta, tejet serioze, të thella dhe

kanë nevojë për qasje të matur dhe të përgjegjshme nga lëmi i Jurisprudencës Islame (fikhu). Ndërhyrjet kirurgjikale, që njihen me termin **“Operacione plastike”** apo **“Kirurgji plastike”** është një fushë e mjekësisë që sot është duke arritur një zhvillim të paparashikueshëm. Prandaj, në këtë shkrim do të rrahim të përcjellim disa njohuri të përgjithshme rreth kësaj fushe dhe qëndrimin që duhet të mbajë mysli-mani në lidhje me aplikimin e tyre në rast nevojë apo edhe gjatë jetës së përditshme.

Temë

Me operacione plastike nënkuptojmë ndërhyrjet kirurgjike përmes të cilave bëhet rregullimi i defekteve të lëkurës dhe të pjesëve të trupit, apo të funksioneve të tyre, qofshin të meta të lindura apo të shkaktuara më vonë në rrethana të ndryshme, siç mund të jenë dëmtimet e marra në një aksident automobilistik, në një rast fatkeqësie me lëndë shpërthyes (zjarr, gaz etj.). Realizimi i operacioneve plastike mund të jetë edhe për qëllime estetike, e thënë me fjalë të tjera, mund të prirën nga synimi për të zbukuruar pjesë të caktuara të trupit. Dega kozmetike e operacioneve plastike është e lidhur me zbukurimin e organeve të trupit, e cila bëhet kryesisht në sipërfaqen e lëkurës, ose në dukjen e ndonjë organi të trupit. Shembuj të këtyre ndërhyrjeve janë edhe operacionet në lëkurën e fytyrës, rregullimet e hundës (**rinoplastikë**), ndërhyrjet kirurgjikale në vesh (**otoplastikë**), largimi i rrudhave nga pjesa e syve (**blefaroplastikë**), ndërhyrjet në gjoks (**mastoplastikë**) etj.

Ndarja e operacioneve plastike

Nga ajo që u përmend më lart mund të themi se kemi lloje të shumta të ndërhyrjeve kirurgjikale, por që, në formë të përgjithësuar, klasifikohen në dy kategori: Operacionet plastike të domosdoshme dhe estetizuese.

1. Operacionet plastike të domosdoshme

Janë ato ndërhyrje që kanë për qëllim largimin e të metave, qofshin defekte, dëmtime apo deformime të ndryshme trupore. Në këto raste, ndërhyrja kirurgjikale mund të jetë e domosdoshme, e lidhur me shëndetin e pacientit, me fjalë të tjera, kërkohet nga mjeku të kryejë operacionin për shkak të shërimit të pacientit. Mirëpo, në disa raste tjera, ndërhyrja mund të mos jetë e domosdoshme, dhe se operimi bëhet për të mënjeluar disa dëmtime që nuk

cenojnë shëndetin e pacientit edhe nëse lihen ashtu.

Me këto operacione rrezikohet jeta dhe shëndeti i individëve të shëndoshë, meshkuj, femra dhe tani gjithnjë e më shpesh edhe të mitur. Për këtë ky veprim është i ndaluar.

a. Të metat apo dëmtimet që shërohen me operacione plastike të domosdoshme janë dy lloje:

Lloji i parë: Deformimet ose defektet që janë shkaktuar jo nga rrethanat e jashtme, por të metat me të cilat lind njeriu dhe ato të meta që shkaktohen

për shkak të sëmundjeve të ndryshme me të cilat goditet njeriu gjatë jetës. Me fjalë tjera kjo ndërhyrje mund të bëhet për dy raste:

- **Të metat e lindura të njeriut**, si p.sh: lindja me gishtërinj të ngjitur ose me gjashtë gishtërinj në duar dhe këmbë, lindja me nofull të lartë të çarë etj.

- **Të metat që shkaktohen** nga sëmundjet dhe infeksionet e ndryshme me të cilat goditet njeriu, si p.sh: Tumoret e ndryshme, që shkaktajnë rënien e mishit nga pjesët e trupit, defektet që i shkaktën sëmundja e

tuberkulozit dhe lebrës (sëmundje e rëndë ngjitëse, që shfaqet në lëkurë me puçrra e me leskra dhe që dalëngadalë e kalb mishin dhe bën që të bjerë) dhe infeksionet e ndryshme.

Lloji i dytë: Të metat që janë fituar aksidentalisht nga rrethanat e jashtme gjatë ndeshjeve, zjarreve apo rasteve tjera. Si p.sh.: Deformimet që shkaktohen në fytyrë nga ndeshjet në komunikacion, djegia e lëkurës nga zjarri, gjymtimet që shkaktohen nga aksidentet e ndryshme dhe bëhet e nevojshme ndërhyrja plastike etj.

b. Dispozita shariatike rreth operacioneve plastike të domosdoshme

Gjatë rasteve kur të metat dhe deformimet janë të dukshme, pa marrë parasysh nëse janë shkaktuar nga rrethanat e brendshme apo të jashtme, atëherë ndërhyrja kirurgjikale është e lejuar.

Arsyeja se përse në këto raste lejohet ndërhyrja kirurgjikale lidhet me sa parashtriam më sipër për të meta dhe deformime që nuk janë normale dhe evitimi i këtyre të metave nënkupton edhe shërimin e pacientit.

Këto të meta janë të dëmshme për personin, për aq sa ndikojnë qoftë konkretisht, qoftë edhe shpirtërisht, prandaj leji i kirurgjisë plastike për këta persona është i lejuar, madje, në shumë raste është edhe i domosdoshëm, nëse ka të bëjë me rrezikimin e shëndetit, sikurse rastet e djegies etj.

Këshilla e vlefshme që japin vetë mjekët është: "Kirurgjia plastike mund t'ju bëjë të ndiheni bukur për pak kohë, por mos rrezikoni jetën tuaj për një aventurë të momentit".

Një sehabi që quhet Usame b. Sherik tregon se me një rast disa njerëz e pyetën Muhamedin, salAllahu alejhi ue selem: "O i Dërguar i Allahut, a të shërohemi kur të sëmuremi? Ai u përgjigj: *"Po, robër të Allahut, kërkonti shërim."* E më pas shtoi: *"Allahu nuk ka dërguar asnjë sëmundje të pashërueshme."* (Shënon Tirmidhiu dhe thotë se hadithi është hasen sahih). Ebu Davudi tregon në sunenin e tij se njëri nga sahabët, gjatë një beteje humbi hundën dhe Muhamedi, salAllahu alejhi ve selem, e lejoi ta zëvendësojë me një hundë ari. Ky hadith është argument i qartë në lejimin e operacioneve plastike në rastet e pësimit të aksidenteve të ndryshme.

2. Operacione plastike estetizuese

Janë ato ndërhyrje kirurgjikale me të cilat zbukurojmë dukjen e pjesëve të caktuara të trupit. Çka do të thotë se këto operacione nuk kanë për qëllim mënjanimin e ndonjë të mete apo defekti në trup, por janë me qëllim të përmirësimit të dukjes, shtimit të bukurisë, estetikës dhe perfeksionit të trupit.

a. Llojet e Operacioneve plastike estetizuese

Edhe operacionet plastike estetizuese janë dy llojesh:

Lloji i parë: Ndërhyrjet në ndryshimin e formës së pjesëve të caktuara të trupit në të gjitha moshat, si: zbukurimi i hundës duke e zvogëluar apo ndryshuar formën; zbukurimi i noful-

lës së poshtme, duke e zvogëluar ashtin apo zmadhuar me vënien e mjekrës artificiale; zbukurimi i gjoksit të femrat, qoftë me ndryshimin e formës së tyre, duke vënë në brendësi silikon, ose me rritjen e tyre me disa lloje të injeksioneve; zbukurimi i veshëve, duke i kthyer ato mbrapa nëse janë të daltë; zbukurimi i barkut duke tërhequr lëkurën dhe duke mënjauar një pjesë të saj etj.

Lloji i dytë: Ndërhyrjet të personat më të moshuar me qëllim të largimit të shenjave të plakjes, si: mënjanimi i rrudhave në fytyrë duke bërë tërheqjen e lëkurës; ngritja e vetullave, pasi gjatë viteve ato bien poshtë; zbukurimi i pjesës së prapme të trupit, duke mënjauar dhjamin; zbukurimi i duarve, duke bërë tërheqjen e rrudhave që janë të pranishme te të moshuarit, etj.

Rreziqet gjatë kryerjes së këtyre operacioneve

Para se të sqarojmë qëndrimin e Islamit rreth këtyre llojeve të operacioneve, është e nevojshme të bëjmë disa sqarime të rëndësishme, çka na ndih ta kuptojmë më mirë dispozitën sheriatike përkatëse në lidhje me këto praktika mjaft të përhapura në kohët tona.

Përdorimi i kirurgjisë plastike në zbukurimin e pamjes së organeve të ndryshme të trupit përbën një dukuri mjaft të përhapur te njerëzit, madje, te një pjesë e madhe është bërë edhe

"Revista Britanike e Operacionit Plastik" (British Journal of Plastic Surgery), në vitin 1995 vinte në dukje se 37,6% e femrave të operuara një herë në mastoplastikë (kirurgjia e gjirit) duhej të operoheshin sërish.

mani. Është i rrallë rasti të dëgjojmë për ndonjë artist e këngëtar të njohur që nuk i është nënshtruar operacionit plastik për të zbukuruar ndonjë pjesë të trupit. Vetëm në vitin 2004, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë bërë 11.9 milionë operacione kozmetike.

Obsesioni për një trup më perfekt i detyron shumë njerëz që t'i hyjnë jo pak rreziqeve, të cilat

mund të përfundojnë edhe me vdekje. Edhe pse në revistat shkencore nuk publikojnë shumë studime rreth kundërindikacioneve dhe rreziqeve gjatë operacioneve plastike kozmetike, le të marrim si shembull ndërhyrjen në **"liposuction"** (ndërhyrja plastike në pjesën e prapme të njeriut). Në një studim të një grupi hulumtuesish të një universiteti amerikan në lidhje me operacionet plastike thuhet se në 5 mijë ndërhyrje të praktikuara në "liposuction" nga kirurgë plastikë të specializuar, një rast përfundon me vdekjeje. Nëse ky fakt është i vërtetë, në Spanjë vetëm në vitin 2003 janë bërë 60 mijë ndërhyrje "liposuction", çka do të thotë që çdo muaj kemi një rast vdekjeje vetëm për ndërhyrjen e "liposuction".

Dështimi dhe përsëritja e këtyre operacioneve është shumë e shpeshtë. "Revista Britanike e Operacionit Plastik" (British Journal of Plastic Surgery), në vitin 1995 vinte në dukje se 37,6% e femrave të operuara një herë në **mastoplastikë** (kirurgjia e gjirit) duhej të operoheshin sërish. Kjo është kështu për shkak se indet në kon-

takt me protezat reagojnë duke formuar një kapsulë indesh fibroze, që me kalimin e kohës tkurren duke deformuar gjoksin, i cili bëhet asimetrik, pra, një femër ka gjinj të përmasave të ndryshme. Këto raste u përkasin operacioneve të dështuara. Në një shtet të Evropës Perëndimore, mesatarisht gjatë një viti kryhen operacione gjiri gjatë të cilave vendosen 25 mijë proteza për të mbushur gjoksin. Sipas një kirurgu, në 50 operacione të bëra, 38 janë persona të operuar më parë (keq) nga kirurgë të tjerë.

Kirurgjia plastike nuk të lejon të kryesh ndërhyrje nën moshën 18 vjeç. Kjo vjen për faktin se defektet e korrigjuara mund të përsëriten, pasi kockat deri në këtë moshë kanë predispozitën më të madhe për t'u rritur. Sipas doktorit, ka shumë raste kur adoleshentët kanë probleme të dallueshme të hundës, por nuk mund të kryejmë kurrësi ndërhyrje. Është shumë e rëndësishme që kockat të rriten në mënyrë normale.

Duke i pasur parasysht rreziqet e mundshme dhe kundër indikacionet që mund të shkaktohen, ekspertët e kësaj fushe u sugjerojnë atyre që kanë vendosur pa nevojë që, para se t'i nënshtrohen briskut të kirurgut, të kontaktojnë me shoqatën e kirurgëve për operacionet plastike (pothuajse në çdo vend të zhvilluar gjendet një e tillë). Këshilla e vlefshme që japin vetë mjekët është: "Kirurgjia plastike mund

t'ju bëjë të ndiheni bukur për pak kohë, por mos rrezikoni jetën tuaj për një aventurë të momentit".

c. Dispozita sheriatike rreth operacioneve plastike estetizuese

Allahu i Lartësuar e krijoi njeriu në formën më të përsosur, në Kur'an thuhet: *"Allahu është Ai që ua bëri tokën vendbanim e qiellin kulm, dhe ju formësoi, e formën tuaj e bëri më të mirë dhe ju pajisi me të mira. Ky është Allahu, Zoti juaj, i lartë, pra është Allahu, Zot i botëve!"* (Gafir, 64)

Zbukurimi dhe dukja e mirë në Islam konsiderohet nga gjërat e lejuara dhe të preferuara. Për këtë kemi argumente të shumta; ndër to urdhri i Allahut të Lartësuar që të dukemi mirë gjatë shkuarjes në xhami, thënia e Muhamedit salAllahu alejhi ve selem: *"Vërtet Allahu është i bukur dhe e do të bukurën"*, pastaj përdorimi i parfumit dhe erërave të mira etj.

Mirëpo çdo gjë ka kufirin e vetë dhe, sikurse në thelb është e lejuar të ushqehemi, pastaj ndalohemi që të ushqehemi me gjëra të dëmshme për organizmin tonë (si mishi i derrit dhe alkooli), ashtu kemi edhe kufij me mënyrën dhe gjërat të cilat lejohet të zbukurohemi.

Ndërhyrjet kirurgjike për të perfeksionuar dukjen e pjesëve të trupit nuk janë të domosdoshme dhe

Është i rrallë rasti të dëgjojmë për ndonjë artist e këngëtar të njohur që nuk i është nënshtruar operacionit plastik për të zbukuruar ndonjë pjesë të trupit. Vetëm në vitin 2004, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë bërë 11.9 milionë operacione kozmetike.

as të nevojshme, por qëllimi është ndryshimi i dukjes që e ka krijuar Allahu i Lartësuar, duke luajtur kot sipas pasioneve dhe epsheve të njerëzve. Me këto operacione rrezikohet jeta dhe shëndeti i individëve të shëndoshë, meshkuj, femra dhe tani gjithnjë e më shpesh edhe të mitur. Për këtë ky veprim është i ndaluar. Ndërsa në rastin e lejimit kemi etikën dhe shëndetin, në rastin e dytë kemi trallisje të momentit.

Argumentet që ndalojnë aplikimin e kirurgjisë plastike estetizuese janë:

Argumenti i parë: Allahu i Lartësuar tregon se si shejtani do të tentojë t'i devijojë njerëzit me mënyra të shumta, ndër to: *“...do t'i urdhëroj dhe ata do të ndryshojnë (shëmtojnë) krijesat e Allahut. E kush bën mik djallin, e jo Allahun, ai ka dështuar sheshazi.”* (Nisa, 119)

Nga ky ajet kuptojmë se nga gjërat me të cilat shejtani do t'i nxisë njerëzit të mëkatojnë dhe ta pasojnë atë është ndryshimi i pamjes së krijesave të Allahut. Kirurgjia plastike bën pjesë në veprime me të cilat bëhet ndryshimi i pamjes së njerëzve.

Ndërhyrja në raste të mënjanimit të të metave dhe defekteve a konsiderohet ndryshim i krijesës së Allahut?

Ndërhyrjet kirurgjikale, si mënjanimi i gishtit të gjashtë nga duart dhe këmbët apo për shkak të mënjanimit të të metave dhe defekteve të ndryshme në trup nuk konsiderohet ndryshim i krijesës së Allahut, pasi kjo e metë në trup është e dëmshme sikurse sëmund-

ja dhe ndërhyrja bëhet për të mënjanuar këtë defekt, e në qoftë me këtë rast ndodh zbukurimi dhe përmirësimi i dukjes, atëherë kjo nuk është esenciale. Kjo vlen edhe në rastet e shërimit të lëkurës së djegur, nëse bëhet me operacion plastik dhe me këtë largohen shenjat e dëmtimeve ose bëhet dukja e mirë dhe zbukurohet atëherë ky zbukurim është i lejuar. Imam Neveviu thotë: “Për sa i përket thënies së Muhamedit, salAllahu alejhi ue selem: *“...ato që zbukurojnë dhëmbët që t'u duken më të bukur...”* fjala është për syresh që e bëjnë këtë për t'u zbukuruar. Nga kjo kuptojmë se e ndaluar është nëse bëhet për estetizëm, ndërkohë që, nëse rregullimi (i dhëmbëve) është i nevojshëm për shkak të defektit në dhëmbë apo diçka të ngjashme, atëherë kjo është e lejuar”.

Argumenti i dytë: Buhariu dhe Muslimi shënojnë një hadith në të cilin Abdullah b. Mesudi thotë: *“E kam dëgjuar të Dërguarin, salAllahu alejhi ue selem, duke e mallkuar atë që bënë tatuazh, heqësen e qimeve, si dhe ato që zbukurojnë dhëmbët që t'u duken më të bukur dhe ndryshojnë pamjen e krijesave të Allahut”.* Në hadith është bashkuar në mes të dukjes së bukur dhe ndryshimit të pamjes dhe këto dy gjëra janë evidente gjatë kirurgjisë plastike për qëllime estetizmi.

Argumenti i tretë: Në shumicën e rasteve këto ndërhyrje përmbajnë mashtrim dhe tradhti, sikurse rikthimi i pamjes së rinuar te të moshuarit. Mashtrimi dhe gënjeshtria është e ndaluar në Islam dhe kjo mund të përdoret në raste të martesave, ku partneri

mund të mashtrohet me pamjen e jashtme të personit me të cilin mund të lidhë martesë, duke fshehur moshën e saktë.

Argumenti i katërt: Gjatë kryerjes së operacionit, njeriu i nënshtrohet disa ndalesave dhe haramëve si: përzierja me burra, respektivisht me gra të huaja, humbja e vetëdijes me anestezi, pasi anestezia është e lejuar vetëm kur është e nevojshme dhe, në këtë rast, ndërhyrja është e panevojshme, prandaj edhe shkelja e këtyre ndalesave me qëllime që i shkojnë pas pasioneve dhe epsheve të njeriut është e ndaluar.

Argumenti i pestë: Kryerja e këtyre operimeve mund të shkaktojë rreziqe të ndryshme, përmasat e të cilave mund të sjellin deri edhe vdekje. Më lart pamë rreziqet e mundshme që u nënshtrohet njeriu në mënyrë të panevojshme gjatë operacioneve të kirurgjisë plastike për arsye estetizmi.

Rezyme e temës

Duke qenë se në këtë temë trajtuam dhe sqaruam disa problematika nevrologjike për kohën në të cilën jetojmë, për të qenë më e kapshme për lexuesin, në përfundim po sjellim thelbin e çështjeve, duke përmendur dispozitën përkatëse në lidhje me të:

Operacionet plastike klasifikohen në dy kategori:

1. Operacione plastike me qëllim mënjanimin e të metave të lindura të njeriut apo të dëmtimeve që mund të jenë shkaktuar nga aksidentet dhe sëmundjet gjatë jetës. Ky lloj është i

lejuar dhe në të nuk ka asnjë pengesë. Argument për këtë kemi rastin kur Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, i lejoi një sahabi që e kishte humbur hundën në luftë ta zëvendësojë atë me hundë ari. (Shënojnë: Ebu Davudi, Nesaiu, Ahmed, Tirmidhiu).

2. Operacion plastik me qëllim të shtimit të zbukurimit dhe estetikës, pra nuk është për të mënjeluar të metat, por për të shtuar bukurinë edhe më shumë, si: ndërhyrja me operacion në fytyrë me qëllim të zbukurimit, bërja operacion e gjoksit për të shtuar estetikën, ndryshimin e ngjyrës së lëkurës etj.

Ky lloj është i ndaluar, pasi Profeti, bekimi dhe pagja qofshin mbi të, i ka mallkuar ato që shkulin vetullat, vendosin në flokë të tyre flokë artificiale (si paruke) dhe ato që bëjnë në trupin e tyre tatuazhe (tatu). (Shënon Muslimi).

Ky lloj i zbukurimit është luks dhe në të nuk ka mënjanim të të metës, prandaj edhe është e ndaluar.

Allahu e di më së miri.

Referencat:

- (1) "Ahkamul Xhiraheti Tibije", dr. Muhamed Muhtar Shinkiti.
- (2) "Çështje Juridike Bashkëkohore Islame", Universiteti "El-Az'har".
- (3) "Ed-devabit esh-Sherije lil Amelijat et- Texhmilije", dr.Hani Abdullah Xhebër.
- (4) "Ed-devabit esh-Sherije li Amelijat Tahsin el Kavam" dr. Abdulaziz Fevzan.
- (5) "Xhirahat et- Texhmil", Fajize Turabije.

Portretizimi dhe karakteristikat e mynafikut

Shkruan: Lulzim SUSURI

I Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Zotit qofshin mbi të, na thotë: “Ai që i ka katër vese është mynafik - dyfytirësh i vërtetë, e nëse zotëron një prej këtyre vetive, zotëron vetitë e mynafikut: kur i besohet diçka dhe e tradhton, kur flet dhe gënjen, kur bën marrëveshje dhe e prish dhe kur armiqësohet me dikë, largohet krejtësisht nga e vërteta (duke i bërë tjetrit padrejtësi).” Këtë hadith e transmeton imam Buhariu, nr. 34, 2459, 3178, Muslimi, nr. 207, Ebu Davudi, nr. 4688, Tirmidhiu, nr. 2632, etj.

Ky hadith është transmetuar edhe me fjalë tjera, në të cilat janë cekur edhe disa veti që nuk përmenden në këtë transmetim, por më i ploti është hadithi i lartpërmendur.

Fjala munafik rrjedh nga folja arabe “nefeka”, që do të thotë: të paraqesësh në anën e jashtme diçka që nuk e ke apo nuk e beson në anën e saj të brendshme.

S’ka dyshim që dyfytirësia është ndër vetitë më të rrezikshme të jobesimtarëve. Përmes kësaj vetie, syresh shfaqin sa për sy e faqe besimin, duke fshehur brenda zemrës kufrin. Për këtë arsye, dyfytirësia, sa herë përmendet nga dijetarët, jepet e lidhur me besimin. Çdokush që mbart brenda

vetes një veti të këtillë, jo vetëm që është kafir, por, çka shfaqet e rëndësishme, është shumë më i rrezikshëm sesa kafirët e tjerë.

Disa dijetarë e trajtuan hadithin e lartpërmendur si problematik, duke u nisur nga ideja se njeriu që mbart këto

katër cilësi nuk mund të cilësohet si kafir, edhe pse i vepron ato. Disa filozofë u munduan të hedhin pluhur mbi senedin e tij, edhe pse ai është më i pastër se loti, pasi nuk dinin t’i gjenin zgjidhje dhe t’i jepnin kup-timin e merituar, e as komentimin e vërtetë.

Nuk ka dyshim se këto vese gjenden edhe tek disa besimtarë, në besimin e të cilëve nuk kemi dyshim, bile të gjitha këto cilësi i kishin vëllezërit e të dër-

E nëse një njeri ndodh të veprojë rrallëherë i udhëhequr nga një ves të tillë, por nuk i është bërë zakon, në këtë rast ai nuk është dyfytirësh në vepra - nuk futet në radhët e mynafikëve - por vepra e tij është vetëm një haram

guarit të Zotit, Jusufit, alejhi salam. Të gjithë dijetarët pajtohen me mendimin se njeriu që e beson Zotin me zemër, e shpreh atë me gojë dhe punon me gjymtyrët e tij sipas rregullave fetare, edhe nëse i ka në vete këto katër vese apo njërën prej tyre ai me to nuk konsiderohet kafir e as “munafik” me të cilën kuptohet kufri.

Komentimi i hadithit

Fjala e të Dërguarit, salAllahu alejhi ve selem: *“Ai që i ka katër vese është mynafik - dyfytërësh i vërtetë, e nëse zotëron një prej këtyre vetive, zotëron vetitë e mynafikut...”*

Sipas mendimit të shumicës absolute të dijetarëve, fjala është për dyfytërësinë në punë, jo në besim

Mendimet e dijetarëve rreth kësaj fjale:

1- Sipas mendimit të shumicës absolute të dijetarëve, fjala është për dyfytërësinë në punë, jo në besim. Kjo, për shkak

se dyfytërësia në besim nënkupton shpalosje të imanit dhe fshehje të kufrit dhe, rrjedhimisht, njeriu që zotëron vetitë e lartpërmendura nuk është i tillë.

2- Po ashtu, kjo fjalë komentohej se njeriu që zotëron këto vese i përngjan dyfytërëshave të vërtetë për nga aspekti se si fshehësi i kufrit që tregon diç që nuk është realitet ashtu edhe ky nxjerrë në pah diç në të kundërtën e të vërtetës.



3- Fshehësi i kufrit është dyfytyrësh karshi islamit, kurse gënjeshtari, tradhtari, mos mbajtësi i premtimit dhe larguesi nga e vërteta gjatë armiqësisë janë dyfytyrësh karshi atyre që dëmtohen nga vënia në veprim e këtyre vetive.

4- Disa dijetarë e komentojnë hadithin e lartpërmendur duke thënë se njeriu mund të zotërojë ndonjë apo disa veti të munafikëve, por kjo nuk do të thotë se ai i tëri është i tillë.

5- Këtu është fjala për njeriun që vepron përmes këtyre vetive, duke mos pasur dert për to, bile edhe duke menduar se janë të lejuara dhe se një veprim i tillë është shpalosje e zotësisë së tij.

6- Hadithi është i posaçëm vetëm për munafikët e kohës së të Dërguarit, salAllahu alejhi ve selem, të cilët e shprehnin shehadetin, porse në formën më të pasinqertë dhe të gënjeshtërt, duke thyer marrëveshjen me të Dërguarin salallahu alejhi ue selem; kur u besohej diçka, e tradhtonin dhe nëse dikush zihej pak me ta, bënë padrejtësi duke mos pasur dert se kanë devijuar nga e vërteta.

7- Një nga dijetarët është shprehur se ky hadith është thënë për një person të caktuar që jetoi në kohën e të Dërguarit, salAllahu alejhi ve selem, e ky i fundit, kur hetoi tek ai këto veti, nuk deshi ta përmendte me emër, por ua tërhoqi vërejtjen të gjithëve, siç e kishte traditë një gjë të tillë.

Mendimi më i saktë:

Sa i përket mendimit të pestë, mendojmë se nuk përfshihet në këtë gjasë, mbasi njeriu që e konsideron si hallall

atë që Zoti e ka shpallur si haram dhe i lejon vetes ta kryejë një gjë të tillë, ky njeri është kafir dhe jo munafik, arsye për të cilën nuk mund të përfshihet në kategorinë që rreh të përqaft ky hadith i të Dërguarit, salAllahu alejhi ve selem.

Përsa i përket mendimit të gjashtë, edhe pse ky hadith është e vërtetë se përfshin munafikët e kohës së profetit, nuk do të thotë se është i posaçëm vetëm për ta; ligjet fetare vlejnë për të gjitha kohët dhe njerëzit, pavarësisht se shkaktar mund të ketë qenë një njeri apo një grupim i caktuar. Ky është rregulli i shkencës së usuli fikhut. Kjo përgjigje vlen edhe për mendimin e fundit.

Mendimi më i saktë në këtë çështje është i pari, i përkrahur nga shumica e dijetarëve. Ata argumentojnë edhe me fjalën e Omerit, që e pyeti Hudhejfen se mos e kishte cekur i Dërguari, salAllahu alejhi ve selem, në mesin e munafikëve. Pra, Omeri nuk kishte dyshim në veten e tij se mos e fshihte kufrin në zemrën e tij, por frikësohej se mos po vepronte diçka me të cilën do të mund të konsiderohej nga radhët e munafikëve. Argument ky të cilin e përmendi imam Kurtubiu dhe e mbështeti Ibën Haxheri. Këtë mendim, nga shumica e dijetarëve e mbështet edhe imam Tirmidhiu.

Sakaq, përsa i përket mendimit të dytë, të tretë dhe të katërt mund t'i konsiderojmë mendime plotësuese të mendimit të parë, pasi nuk janë në kundërshtim me të dhe bartin në vete domethënie vërtet të dobishme.

Fjala e të Dërguarit, salAllahu alejhi ve selem: “Kur i besohej diçka, e

tradhton, kur flet, gënjen, kur bën marrëveshje, e shkel dhe kur armiqësohet me dikë, largohet krejtësisht nga e vërteta (duke i bërë tjetrit padrejtësi)."

Këto fjalë janë të qarta dhe të kuptueshme dhe nuk kanë nevojë për komentim të gjërë.

"Kur i besohet diçka, e tradhton"- pra nuk është njeri i besës, përkundrazi, është tradhtar.

"Kur flet, gënjen"- është gënjeshtar.

"Kur bën marrëveshje, e shkel"- nuk është njeri që respekton marrëveshjet e bëra me të tjerët. Këtu hyjnë të gjitha marrëveshjet, ato me besimtarët dhe kafirët, miqtë dhe armiqtë, në kohë të paqes

apo të luftës, pa marrë parasysh nëse besimtari ka dobi private apo fetare nga thyerja e asaj marrëveshje, një gjë e tillë nuk lejohet. Kjo për shkak se duhet t'i qëndrojmë besnik fjalës së dhënë, që do të thotë qartas se çdo dobi që vjen si rrjedhojë e tradhtisë është e ndaluar dhe prej saj nuk ka dhe nuk mund të pritët bereqet.

"Kur armiqësohet me dikë, largohet krejtësisht nga e vërteta (duke i bërë tjetrit padrejtësi)."- ndoshta, kur është rehat vëren tek ai devotshmëri dhe sjellje të mirë por, në momentin që hidhërohet apo fërkohet me dikë tjetër, nuk i intereson shoqëria apo vëllezëria, për të është me rëndësi të arrijë tek qëllimi i tij, madje, edhe në mënyra të palejuara. Ndoshta i bëhet

Disa dijetarë e trajtuan hadithin e lartpërmendur si problematik, duke u nisur nga ideja se njeriu që mbart këto katër cilësi nuk mund të cilësohet si kafir, edhe pse i vepron ato. Disa filozofë u munduan të hedhin pluhur mbi senedin e tij, edhe pse ai është më i pastër se loti, pasi nuk dinin t'i gjenin zgjidhje dhe t'i jepnin kuptimin e merituar, e as komentimin e vërtetë.

një e keqe apo padrejtësi e vogël, çka ai e kthen disa fish më tepër, edhe pse gjasa mund ta kërkojë t'ia falë tjetrit që të fitojë shpërblim dhe të vërtetojë besimin e tij. Kur armiqësohet, nuk ka kriter tjetër vetëm se si t'ia kthejë tjetrit si mos më keq.

Në këto katër cilësi të mynafikut të cekura nga i Dërguari, salAllahu alejhi ve selem, duhet ta kemi parasysh se njeriu për t'u konsideruar i tillë duhet vazhdimisht apo në shumicën e kohës së tij të punojë sipas këtyre veseve. Për këtë shkak, i dërguari, kur i numëroi vetitë e tij në fillim të çdo

vetie, tha fjalën: "Kur" - fjalë që, siç e cekëm, nënkupton vazhdueshmërinë, gjithmonë apo në shumicën e rasteve. Pra, ai kur i besohet diçka, gjithmonë apo në shumicën e rasteve tradhton, kur flet, zakonisht gënjen... E nëse një njeri ndodh të veprojë rrallëherë i udhëhequr nga një ves të tillë, por nuk i është bërë zakon, në këtë rast ai nuk është dyfytirësh në vepra - nuk futet në radhët e mynafikëve - por vepra e tij është vetëm një haram - mëkat i madh, për të cilin është nën mëshirën e Allahut nëse do ta falë me mëshirën e Tij, apo nëse do ta dënojë me drejtësinë e Tij.

Zoti na faltë mëkatet tona dhe na ruajt nga veset e munafikëve.

Martesa nëpërmjet internetit



Hajre TUHAJRI

Jurisprudenca, gjatë shekujve, me degë dhe sisteme të ndryshme, i përcaktonin kontratat dhe të drejtat financiare në mënyra të ndryshme. Ndryshimet prekin kryesisht mënyrat dhe format e kontraktimit, kushtet, dispozitat dhe pasojat që rridhnin prej marrëveshjeve. Disa legjislacione arritën dora-dorës të kushtëzonin deri edhe formalitetin që lipsej ndjekur gjatë kontraktimit, aq sa një kontratë e kryer jo sipas formës dhe mënyrës së caktuar konsiderohej e pavlefshme. Me kalimin e kohës, ajo arriti në pikën kur

kushti i vetëm ishte pajtimi i ndërsjellët mes palëve.

Nuk është kundër përdorimit të mjeteve bashkëkohore të komunikimit gjatë kontraktimit, por çështjen e martesës Sheriati e ka rrethuar me kushte, procedura dhe formalitete si dëshmimi, lajmërimi që nuk mund të plotësohen me anë të internetit.

Sheriati, si sistem legjislativ hyjnor, duke ndjekur me përpikëri porosinë e ajetit: *“O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni rënë në ujdin e njëri-tjetrit...”* (En Nisa, 29), e konsideron pëlqimin dhe miratimin e ndërsjellë si shtyllë e të gjitha kontratave, pa dallim forme. I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Shitblerja kryhet nëse ka pëlqim të ndërsjellë”*.

Kontraktimi me anë të

Kjo formë procedurale është tejet e dyshimtë dhe e rrezikshme, pasi ofron mundësi që vajza myslimane të martohet pa lejen e kujdestarit të saj, të nënshkruhen kontrata kurorëzimi të pavlefshme, që nuk mbështeten në themele dhe rregulla fetare.

internetit, në thelb ka të bëjë me dy palë që i bashkon një kohë, por që janë të ndarë nga aspekti vendor. Sipas një studimi të kohëve të fundit, kontraktimi me anë të internetit, me format e tij (ëeb-site, E-mail, messenger) është një prej mënyrave më të përhapura dhe me të shumta në numër. Pajtimi i ndërsjellë është kusht në gjitha këto forma dhe lloje të kontratave. Sipas mendimit të Dr. Abdullah b. Ibrahim en-Nasir, metodologjia islame, duke e vendosur theksin te miratimi i ndërsjellë në gjitha kontratat, është mrekulli e vërtetë e Sheriatit, i cili vërteton faktin se bëhet fjalë për një legjislacion që vlen dhe është i aplikueshëm në çdo kohë dhe vend, në çdo shoqëri dhe mjedis. Zhvillimi i stuhishëm i mjeteve të ndryshme të komunikimit në përgjithësi dhe teknologjisë elektronike në veçanti, ka bërë të mundur gjatë viteve të fundit pushtimin e të gjitha domeneve të jetës, përfshirë këtu edhe domenin e tregtisë. Kështu që, herët a vonë dolën në skenë shitblerjet në rrugë autom- atike, tregtia e internetit, tregtia elektronike... Rrjeti i internetit është shndërruar sot në një mjet efektiv dhe shfrytëzohet në aspekte të ndryshme të jetës

Por problemi lind kur çështja ka të bëjë kontratën e kurorëzimit.

njerëzore. Shumë nga marrëveshjet kontraktohen duke përdorur internetin si medium që ndërlidhi botën dhe fshiu kufijtë gjeografike. Shumë kompani botërore dhe lokale hapën faqe të veçanta në rrjetin e internetit. Edhe pse kaq i rëndësishëm, interneti nuk u bë temë e studimeve të mjaftueshme nga pikëpamja e jurisprudencës islame. Akoma më të paktë janë hulumtimet që ofrojnë alternativë në rastet kur përdorimi i internetit nuk përkon me dispozitat e Sheriatit Islam.

Punimi shkencor i paraqitur në konferencën e Gjyqësisë Islame me titull *Kontratat e verifikimit me anë të mjeteve bashkëkohore të komunikimit*, i Dr. Hail Abdul Hafidh, shef i katedrës për Fikh dhe jurisprudencë Islame pranë universitetit shtetëror në Jordani, pohon se kontraktimi me anë të mjeteve bashkëkohore të komunikimit është i ligjshëm me gjitha llojet e kontratave dhe pasojave ligjore. Këtë gjykim e mbështet në faktin se të gjithë kontraktuesit e dëgjojnë dhe e shohin njëri-tjetrin dhe se një kontratë e tillë nuk dallon nga ato që bëhen në kushte normale, por problemi lind kur çështja ka të bëjë kontratën e kurorëzimit. (KËTO DYJA JANË NJË BOX) Martesa, si institucion i rëndësishëm, i cilësuar nga disa si i shenjtë, i cili ka pasoja të rëndësishme, me të drejtë kërkon një kujdes të veçantë gjatë gjyqimit. Pas paraqitjes së qeverive elektronike, koordinimit elektronik, dukuria

që tërheq vëmendjen është paraqitja e ofiqarëve elektronikë. Në hapësirat e këtij rrjeti gjejmë adresa të ofiqarëve, oferta për këshillim martesor, dhe oferta të dokumenteve përkatëse që

vërtetojnë kontratën e kurorëzimit. Në ato faqe ofrohet edhe hapësira për dëshmitarët e aktit martesor!?

Disa vende, mes të cilave edhe Rusia, i kanë zyrtarizuar këto sajte dhe i kanë shpallur të vlefshme aktet e kurorëzimit të realizuara sipas kësaj forme procedurale. I vetmi kusht është që faja elektronike të lidhet me zyrën e verifikimit të kurorëzimeve elektronike të shtetit rus. Zbatimi i këtij projekti do të testohet brenda vitit të ardhshëm në tërë territorin e shtetit rus. Nga ana tjetër, në Egjipt, një gjë e tillë vazhdon pa sistematizim dhe rregullim ligjor, bile edhe pa mbikëqyrje të këtyre faqeve. Pyetja që parashtrohet është, kurorëzimet që kryhen me anë të këtyre ueb faqeve a janë të vlefshme nga aspekti fetar dhe ligjor?

Numrat e disa hulumtimeve flasin se faqet e këtij lloji në gjuhën arabe arrijnë dyqind. Numri i vizituesve arrin tetë milionë të rinj, që hulumtojnë për partnerin e jetës. Në shumicën e rasteve shërbimet e këtyre faqeve janë me pagesë dhe nuk është kusht që klienti të jetë në moshë rinore. Për të përfituar nga shërbimet e disa faqeve, paraqitja e të dhënave personale për klientin e mundshëm është kusht që duhet plotësuar. Një gjë e tillë nuk kërkohet nga ueb faqe të tjera. Statistikat botërore mbi përmasat e tregut të këtij lloji, shërbimi i martesës me anë të internetit, kanë arritur shifra marramendëse. Përqindja e madhe e të pamartuarve, në veçanti e femrave në moshë të shtyrë, është shkaku më i madh i popullaritetit të këtyre faqeve. Është rritur dukshëm numri i personave mbi tridhjetë e pesë vjet që nuk janë martuar.

Kontraktimi me anë të mjeteve bashkëkohore të komunikimit është i ligjshëm me gjitha llojet e kontratave dhe pasojave ligjore.

Një përvojë e re, si martesa me anë të internetit, me siguri s'ka shpëtuar nga mundësia për mashtrim dhe gënjeshtër. Shumica mban qëndrimin se një akt i tillë nuk ka peshë ligjore, për shkak të mungesës së dëshmitarëve në praninë e ofiqarit/zyrtarit të autorizuar. Me mos-prezencën e dëshmitarëve nuk plotësohet kushti i dëshmimit të kurorëzimit. Një problem tjetër është mos-prezenca e djalit dhe vajzës që dëshirojnë të lidhin kurorë martesore. Shndërrimi i ritualit martesor në një formalitet të mbushjes së formularëve të shfaqura në monitorin e kompjuterit, është diçka që arsyeja e shëndoshë nuk mund ta pranojë dhe është në kundërshtim me shtyllat e martesës së saktë. Ideja e ofiqarit elektronik në këtë mënyrë, sipas mendimit të dr. Abdun-Nasir Ebul Basal, lë hapësirë pjellore për lajka, mëkëmbje të të drejtave dhe mos verifikim të kontratave. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shkukurorëzimin me anë të SMS, porosisë të dërguar me anë të celularit ose me anë të telefonatës. Këshilli për fetva ishte i vendosur në ndalimin e një gjëje të tillë.

Dr. Muhammed El Mesir, profesor i akidës dhe filozofisë pranë universitetit Al Az'har, pohon se plotësimi i kontratës martesore, nuk arrihet në rast se mungon ballafaqimi dhe takimi mes gjitha palëve. Nëse nuk ndodh takimi atëherë si do të dëshmojë dëshmitari, kur nuk i sheh të dy palët, si do të plotësohet ixhabi (shqiptimi i fjalëve të martova me bijën time filanen) dhe kabulli (shqiptimi i fjalës pranova) në formë të qartë dhe transparente? Nuk mund të mjaftohemi

me zërin e mikrofonit, sepse kështu do të futemi në rrëmujë të vërtetë. Në vazhdim të shtjellimit të tij ai këshilloi të mos jepemi me tërësinë tonë pas modës teknologjike, me dëshirë të flakët për kopjimin e perëndimit. Nuk ka nevojë që një vendim aq i rëndësishëm jetësor të kryhet me anë të procedurës së dyshimtë (tech-ëay).

Katastrofë e vërtetë është fakti se gjëra të këtilla kryhen me anë të ueb faqeve personale, larg kornizës së mbikëqyrjes shoqërore, fetare dhe pa rregullim ligjor. Kjo formë mundëson kryerjen e martesës pa plotësimin e kushteve, pa fejesë, pa njoftim të vërtetë dhe serioz, pa tubim për kurorëzim, pa e parë djali vajzën me të cilën do të lidhë kurorë martesore... Kjo formë procedurale është tejet e dyshimtë dhe e rrezikshme, pasi ofron mundësi që vajza myslimane të martohet pa lejen e kujdestarit të saj, të nënshkruhen kontrata kurorëzimi të pavlefshme, që nuk mbështeten në themele dhe rregulla fetare, bile ka mundësi të shkruhet në një formë që bie ndesh me mësimet e fesë Islame. Qëndrimi i dr. Hail Abdul Hafidh është plotësisht i kundërt. Në intervistën e kryer me të, ai pohon se nuk ka rrezik nga kurorëzimi elektronik. I pyetur për nevojën e verifikimit të kurorëzimit pranë gjyqit përkatës, ai u përgjigj se nevojitet zbulimi i mënyrës për kryerjen e verifikimit, që qëndron si parakusht për parandalimin e padrejtësive dhe shkeljen e të drejtave individuale. Ai propozon kryerjen e kurorëzimit nën mbikëqyrjen e ndonjë institucionit

Sipas një studimi të kohëve të fundit, kontraktimi me anë të internetit, me format e tij (ëebsite, E-mail, messenger) është një prej mënyrave më të përhapura dhe me të shumta në numër.

zyrtar ose fetar. Ai gjithashtu shton se: kurorëzimi mund të kryhet pa praninë e ofiqarit ose pa e kryer në zyrat e gjyqit përkatës; mjafton dërgimi i dokumenteve të nevojshme (letërnjoftimet, dëshmia e dëshmitarëve etj) të skanuara në adresën elektronike të gjyqit përkatës, të cilat pastaj do t'u nënshtrohen kontrollit të imët për saktësinë e të dhënave, e gjithë kjo nën mbikëqyrjen e institucionit përkatës ligjor/fetar. Një gjë e këtillë nuk duhet t'u lihet në duar ueb faqeve jozyrtare. Kjo çështje kërkon hulumtim më të gjerë me përfshirje të ekspertëve të teknologjisë informative si dhe të dijetarëve të fesë, për të vendosur përkufizimet dhe rregulloren e nevojshme.

Dekani i fakultetit të Sheriatit pranë universitetit të Sharikasë, në Emiratet e Bashkuara Arabe, Abdun Nasir Ebul Basal, thotë se, parimisht, nuk është kundër përdorimit të mjeteve bashkëkohore të komunikimit gjatë kontraktimit, por çështjen e martesës Sheriati e ka rrethuar me kushte, procedura dhe formalitete si dëshmimi, lajmërimi që nuk mund të plotësohen me anë të internetit. Ai shton: sa i përket gjyqit elektronik, mendoj se një propozim i tillë duhet t'i paraqitet *Asamblesë Botërore të Fikhut*, të sqarohen të gjitha detajet dhe intesitetë, duke theksuar nevojën e garantimit të sigurisë gjatë procedurës, mbrojtjen e familjes dhe zgjedhjes së shëndoshë, sepse flasim për një nga gjërat më të shenjta në jetën tonë.

Përktheu: Talha Kurtishi

*Dosja e gabimeve
që bëj ndaj
fëmijëve të mi*

Dosja e gabimeve që bëj ndaj fëmijëve të mi

“Ndërsa i kujtonte popullit të tij ditën e Allahut (për begatitë e sprovat e kaluara) Musai u pyet: kush prej njerëzve është më i ditur?

U përgjigj: Unë jam më i dituri.

Allahu e qortoi për këtë, pasi nuk e ktheu çështjen tek Ai, subhanehu ue teal.

Allahu i shpalli Musait: Një rob i Imi është te vendtakimi i dy deteve, ai është më i ditur se ti.

Musai tha: o Zot, si mund të takohem me të, më udhëzo!” (Muslimi)

Ishte ky një gjest i shkëlqyer eduka-

tiv që bëri Musai, pranoi gabimin e tij dhe iu përgjigj me të shpejtë qortimit dhe korrigjimit hyjnor.

Këtë gjest të mirë të Musait e trashëgoi Jusha b. Nun, që pranoi gabimin e tij kur tha: **“Kur ndaluam tek ai shkëmbi, unë e harrova peshkun. Vetëm djalli më bëri ta harroj e nuk ta thashë se peshku mori rrugën nga deti në mënyrë të habitshme”** (Kehf: 63) Allahu i Madhëruar e bëri të amshuar rastin e tij në Kur’an.

I njëjtë është edhe rasti i Ademit dhe

Havasë, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi ta, kur pranuan mëkatin e tyre. Ata me të shpejtë iu kthyen Zotit. Ata të dy thanë: ***“Zoti ynë, ne i bëmë të padrejtë (e dëmtuam) vetvetes sonë, në qoftë se nuk na falë dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve!”*** (A'raf: 23)

Qorto vetveten së pari

Kur'ani na udhëzon që kur të na ndodh ndonjë e keqe, duhet që të pranojmë gabimin e jo të arsyetohemi e as të ikim prej përgjegjësisë. Hapi i parë i ballafaqimit me vetveten është autokritika, pra të kërkojmë gabimet dhe të metat personale para se të qortojmë të tjerët. Ky është një nga mësimet më të theksuara që e mori gjenerata e parë pas fatkeqësisë së Uhudit: ***“E kur juve u goditi një dështim (në Uhud) e që ju ia patët dhënë atë dyfish (armikut në Bedr), thatë: “Prej nga kjo”? Thuaj: “Ajo është nga vetë ju”! S'ka dyshim se Allahu është i plotëfuqishëm për çdo send.”*** (Ali Imran: 165)

Natyra njerëzore

Parimisht, gabimi nuk llogaritet si e metë. Po ashtu edhe rënia në mëkat, e kjo për shkak se pagabueshmëria u takon vetëm pejgamberëve. E

“Ç'mendon, mësimet e jetës i more nga ata që të lavdëronin, përkrahnin dhe përkëdhelnin, apo nga ata që të sulmonin, të linin pas dore dhe ishin të ashpër ndaj teje?!”

metë është vazhdimi në gabim dhe moslënia e mëkatit. Lëvdata është për atë që pendohet ***“çdo bir i Ademit është gabimtar, më i miri prej tyre është ai që pendohet.”*** (Tirmidhiu)

Vlera e pranimit të gabimit

Pejgamberi, lavdërimi dhe pagja e Allahut qofshin mbi të, na ka treguar për vlerën e madhe të pranimit të gabimit: ***“Kërkimi më i mirë i faljes është të thuash: o Allahu im, ti je Zoti im dhe përpos Teje nuk ka Zot të denjë. Ti më krijove dhe unë jam rob i yt. Unë qëndroj në besën dhe premtimin që të kam dhënë sa kam mundësi. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga sherri që kam bërë. Pranoj se më ke begatuar dhe pranoj mëkatet e mia. Më fal mua se vërtet nuk mund t'i falë mëkatet dikush tjetër pos Teje.”*** Ai thotë: ***“Kush e thotë këtë lutje gjatë ditës me bindje të plotë dhe vdes para se të arrijë mbrëmjen hyn në Xhenet. Kush e thotë gjatë natës me bindje të plotë dhe vdes para se të arrijë agimin hyn në Xhenet.”*** (Buhariu)

Marrëzitë që kam bërë

Të bërtita më hidhërim sepse kishe tollovitur disa gjëra në dysheme. Në sofrën e kafjallit t'i numërova gabimet një pas një; e derdhe supën, e gëlltite ushqimin, u mbështete me bërryla në sofër dhe kosin e përdore pa kontroll...!

Përmendëm se, nga shkëlqimet e edukatës së mirëfilltë, hapi i parë është pranimi i gabimit në vetvete, pastaj para të tjerëve. Një ekspert i raporteve me njerëz thotë: ***“Në zyrën time kam një sirtar në të cilin kam lënë një dosje speciale në ballinën e së cilës shkruhen fjalët “marrëz-***

itë që kam bërë". Ky është një regjistër i mjaftueshëm të cilin kur e lexoj, ndiej se jam i gatshëm të balafaqohem me probleme shumë më të mëdha dhe të dhimbshme. Në këtë më ndihmon kritika që i bëj vetes në të kaluarën.

Në të kaluarën e kisha zakon që t'i fajësoja të tjerët për problemet që më ndodhnin, mirëpo, me kalimin e viteve dhe me shtimin e përvojës kuptova se për fatkeqësitë që më ndodhin fajtori jam unë vetë. Mendoj se shumë njerëz e kanë kuptuar atë që kuptova unë, siç ka thënë Napoleoni ndërsa po jepte amanetin në ishullin Santa Helenës: "Askush përpos meje nuk është përgjegjës për disfatën time. Unë isha armiku më i madh i vetvetes."

Franklini kishte zbuluar trembëdhjetë gabime të rrezikshme që i bënte vazhdimisht. Më të rëndësishmet prej tyre ishin tre: humbja e kohës kot; angazhimi me gjëra të parëndësishme; polemika.

Uollt Uitmani thoshte: "Ç'mendon, mësimet e jetës i more nga ata që të lavdëronin, përkrahnin dhe përkëdhelnin, apo nga ata që të sulmonin, të linin pas dore dhe ishin të ashpër ndaj teje?!"

Shpërbleje gabimin më të mirë

Është shumë interesante se kjo është parulla e re e kompanisë "**Progan**", një agjenci informimi në **Detroit**.

Ndonjëherë mund të bësh ndonjë gabim në punën tënde dhe duhet ta paguash shumë shtrenjtë,

mirëpo në këtë kompani puna qëndron ndryshe. Qysh para katërmbëdhjetë viteve **Masi Progan**, drejtoresha e kompanisë, vuri rregullin: "*gabimi më i mirë i muajit*". Bëhet fjalë për shpërblimin e punëtorëve që pranojnë para kolegëve të tyre gabimet që kanë bërë, me qëllim që t'i mos përsërisin më. Në mbledhjen mujore, pasi nëpunësit votojnë për gabimin më të mirë, fituesi merr 50 dollarë.

A nuk është kjo metoda më e mirë për ngritjen e përgjegjësisë?

Pse përqendrohemi në sukseset tona e jo në dështimet tona?

Të gjithë njerëzit fitojnë nga dështimet e jo nga sukseset e tyre. Pastaj, të mos harrojmë se pranimi i gabimit është vlerë dhe këtë e bëjnë liderët.

Prindi pranon gabimin

Kur do ta kuptojnë prindërit se sjelljet e tyre, të mira qofshin apo të këqija, janë njëloj si pasuria që do të trashëgojnë fëmijët gjeneratë pas gjeneratë?! Nuk është turp që babai apo nëna të ndalen për një moment dhe të bisedojnë sinqerisht me vetveten, për

të larguar nga gjoksi i tyre këtë barrë të rëndë. Të mos krenohen me mëkat, por të rehatojnë zemrën dhe të pranojnë gabimet ndaj fëmijëve të tyre. Madje, qoftë edhe fshehurazi, duke i shkruar në letër! Ndoshta do t'u ndihmojnë të tjerët të mos bien në të njëjtat gabime.

Le të meditojmë së bashku fjalët e një mesazhi të shkëlqyer që paraqet një

Në të kaluarën e kisha zakon që t'i fajësoja të tjerët për problemet që më ndodhnin, mirëpo, me kalimin e viteve dhe me shtimin e përvojës kuptova se për fatkeqësitë që më ndodhin fajtori jam unë vetë.

edukatë botërore me titull “Babai harron”:

“O biri im! Po e shkruaj këtë ndërsa ti je i shtrirë para meje në shtratin tënd, në gjumë të thellë, me faqen e venduar mbi dorën tënde të vogël dhe flokët e shprishur mbi ballin tënd të njomë.

Para disa çasteve isha në zyrën time duke lexuar gazetë. Më kaploi një keqardhje e madhe. Nga mospërmbajtja ime kam bërë disa gabime ndaj teje. Zemra më vlon si në zjarr.

Shikoi shkaqet që më shkaktuan keqardhjen:

A të kujtohet mëngjesin e ditës...?! Ndërsa ti vishje rrobat për të shkuar në shkollë, unë të qortova ashpër, sepse nuk doje të laje fytyrën... Të qortova edhe për faktin se nuk i kishe pastruar këpuçët si duhet...! Të bërtita më hidhërim sepse kishe tollovitur disa gjëra në dysHEME. Në sofrën e kafjallit t'i numërova gabimet një pas një; e derdhe supën, e gëlltite ushqimin, u mbështete me bërryla në sofër dhe kosin e përdore pa kontroll...!

Pasi u drejtove kah lodrat tua dhe unë u nisa për në stacionin hekurudhor, ti u ktheve kah unë dhe ma bërë me dorë dukë bërtitur: rrugë të mbarë, baba! Unë të ktheva shpinën dhe nuk t'u përgjigja.

Në mbrëmje sërish përsërita të njëjtën gjë: ndërsa kaloja rrugën pashë se ti po lozje i shtrirë për tokë, dhe çorapet të ishin grisur. Unë të bëra të nxiheshë në turp para moshatarëve të tu ngase të urdhërova të ecësh para meje drejt shtëpisë e ti qaje dhe ishe i

Hapi i parë i bal-lafaqimit me vetveten është autokritika, pra të kërkojmë gabimet dhe të metat personale para se të qortojmë të tjerët.

hidhëruar. Unë të thosha gjithnjë: çorapet t'i kam blerë shtrenjtë, po t'i kishe blerë vetë, do të kujdeseshë më shumë.”

A mund të përfytyroni të veprojë kështu një baba?!

“Pas asaj, a të kujtohet ndërsa po lexoja në dhomën time, si erdhe tek unë, duke lëvizur këmbët

me vështirësi, ngase frikësoheshe. Në sytë tu shihej qortimi i heshtur. Largova gazetën dhe u nevríkosa, pse më prishe qetësinë, të pyeta me britmë, çfarë do?”

Ti nuk the asgjë porse me të shpejtë më përqafove e më puthe. Ma shtrengove qafën me dy krahët e tu të vegjël me një emocion që Allahu kishte vendosur në zemrën tënde të pastër.

Pastaj ike me vrap dhe u ngjite lart në dhomën tënde.

O biri im! Pas kësaj nuk kaloi veç se pak kohë e gazeta më ra prej dore dhe një dhembje më shtrengoi zemrën.

O Allah! A thua vallë deri ku do të më çonte mua ky “zakon”..?

Zakoni i gjurmimit të gabimeve...

Zakoni i qortimit dhe ashpërsisë...

A thua valle meritove ato qortime pse ishe fëmijë?

Assesi! Nuk ishte puna se s'të kam dashur, jo, porse kam kërkuar shumë prej teje, edhe pse ti ke qenë shumë i vogël.

Të kam krahasuar me veten në moshë dhe përvojë.

Vazhdon...

Shqipëroi: Agim Bekiri

Drejtuar grave të hoxhallarëve



Lëshoji "shigjetat e natës" pas mesnate dhe lute Allahun për burrin tënd dhe për të gjithë ata që thërrasin në të Vërtetën, që t'i forcojë Allahu dhe t'ju ndihmojë.

Fatime EL-BETTAH

"Pas çdo burri të madh qëndron një grua."

Ndaj këtij proverbi dallojnë këndvështrimet e njerëzve prej përkrahësve dhe kundërshtuesve të tij. Mirëpo mendoj se të gjithë pajtoheni rreth rëndësisë që ka bashkëshortja në jetën e njerëzve dhe të gjithë besojmë se ajo ka një rol të rëndësishëm, që, nëse e luan si duhet, anija do të lundrojë ashtu siç duan kapitenët e saj. Për këtë arsye i dërguari i Allahut, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, përmend në shumë raste rëndësinë e gruas, sa që ua ka tërheq vëmendjen rinisë për anën obliguese të gjetjes së femrës me moral islam, e cila i frikohet Zotit në detyrat e saj ndaj burrit, shtëpisë dhe fëmijëve.

Mendoj se të gjithë do të pajtoheni me mua, se hoxha, si thirrës në rrugën e Allahut, është njeriu më i nevojshëm që të ketë një grua të dalluar, që ecën pas tij, qëndron në shtëpinë e tij dhe i ndihmon

në përmbushjen e misionit të tij. Përse lipset patjetër të jetë kështu? Për disa arsye, është përgjigja. Ndër arsyet më të rëndësishme:

1. Vetë dallimi i hoxhës nga të tjerët. Ai dallon prej të tjerëve në shumë aspekte. Dinamika e kohës së tij nuk është njëlloj me atë të të tjerëve. Preokupimet e tij dallojnë nga preokupimet e të tjerëve dhe në këtë mënyrë punët dhe angazhimet e tij dallojnë nga punët dhe angazhimet e të tjerëve.

Nëse një njeri i thjeshtë zakonisht nuk ka preokupime, përveç atyre personale si ana sociale, shtëpia, fëmijët etj., thirrësi nuk mbetet vetëm me preokupimet e tij personale, por ato tejkalojnë nevojat e tij dhe ngrihen në shkallën e përmirësimit të gjendjes së umetit në përgjithësi dhe largimin e njerëzve prej realitetit tronditës në të cilin po jetojmë. Pra, në kohën kur njerëzit e tjerë përpiqen tërë kohën rreth familjes dhe plotësimit të

nevojave dhe dëshirave të tyre, thirrësi e ka agjendën aq dinamike, saqë koha e tij e ndarë për familjen e tij është shumë e ngushtë.

Në këto suaza, nëse gruaja që qëndron pas këtij burri hoxhë nuk dallon nga të tjerat me vizionin e saj rreth gjërave të ndryshme si dhe me preokupimet dhe ambiciet e saj, nuk ka dyshim se “anijes së hoxhës” do t’i vështirësohet rruga e lundrimit, e ndoshta edhe më keq, kjo mund të kuptohet si bllokadë e veprimtimit të saj.

Përfytyroni një hoxhë thirrës, që, sa herë kthehet në shtëpi, pas mundit që ka bërë dhe angazhimit të tij, me të cilat synon kënaqësinë e Allahut, e gjen një grua që fillon ta shfaq mërzitjen e saj dhe monotoninë që e ka përjetuar kohë të gjatë duke ndenjur e vetmuar. Ose fillon t’ia numërojë burrit të saj listën e gjatë të kërkesave, që nuk mund t’i përballojë ato aspak.

Përfytyroni një grua, e cila e shikon gjatë burrin e saj thirrës dhe mahnitet me idetë e tij që i posedon dhe me ambicien e tij të lartë, që e bën të vrapojë vazhdimisht në përmirësimin e gjërave që kanë të bëjnë me popullatën e përgjithshme, e jo me problemet personale të gruas së tij? Sikur e shoh këtë grua duke u orvatur ta largojë burrin e saj nga vendosmëria e tij dhe dalëngadalë të zvogëlojë elanin e tij të entuziazmit që ka për Fe dhe Umet, dhe punon palodhshëm për futjen e pesimizmit në brendinë e tij duke i përmendur gjëra të shumta, të cilat është vështirë të ndryshohen.

2. Vështirësitë dhe rreziqet e shumta,

Përfytyroni një hoxhë thirrës, që, sa herë kthehet në shtëpi, pas mundit që ka bërë dhe angazhimit të tij, me të cilat synon kënaqësinë e Allahut, e gjen një grua që fillon ta shfaq mërzitjen e saj dhe monotoninë që e ka përjetuar kohë të gjatë duke ndenjur e vetmuar.

Ose fillon t’ia numërojë burrit të saj listën e gjatë të kërkesave.

me të cilat ballafaqohet thirrësi në rrugën e tij. Këto gjëra e bëjnë këtë hoxhë me nevojë të domosdoshme që ta ketë një grua, e cila i kupton nevojat e intervalit, që po e jeton burri i saj dhe po kalon nëpër të, andaj duhet të durojë dhe të nxisë për durim. Duhet të bindet se burri i saj nuk është i vetmi, që po ec mbi këtë rrugë të mbushur me gjemba dhe përjetime të vuajtura. Historia është e mbushur me emra të burrave, gjakrat e të cilëve ishin çmimi i parimeve të tyre të larta, të cilat i përqaftuan dhe luftuan

për përhapjen e tyre. Ajo duhet të bindet gjithashtu se qederet, që e rrethojnë burrin e saj, nuk do të thotë se e ka humbur betejën. Mund të ndodh që fitorja të jetë e mbështjellë me petkun e humbjes. Sa herë njerëzit janë habitur me ideologji e parime të ndryshme, të cilat i tejkaluan kufijtë e normales, të inkorporuar nga bartësit e tyre për t’u jetësuar dhe për t’i trashëguar brezat më pas!

Ndërsa nëse në shtëpinë e bashkëshortit thirrës, nuk ekziston një grua e vetëdijshme, e cila beson në këtë që u tha, pa dyshim ajo shtëpi e ka humbur balancën familjare, gjë e cila do të ndikojë negativisht në sjelljet e anëtarëve të familjes, djem e vajza.

3. Nevoja e fëmijëve të thirrësit për një nënë besimtare, të dalluar, që i përballon angazhimet për përmirësimin dhe edukimin e tyre gjatë kohës së mundshme dhe shumë të shpeshtë të mungesës së babait të tyre.

Kur ta dimë se disa nga këta thirrës

kolosë, janë begatuar me fëmijë që nuk i kanë parë, kjo gjë na e shton bindjen, se thirrësi ka nevojë për një grua, e cila ndryshon nga gratë e tjera. Po ashtu na shtohet bindja edhe më tepër, se kjo grua duhet të ketë edukatë të veçantë, që e përgatit të përballë me sfida të ndryshme dhe përgjegjësi të mëdha në jetën e saj, në mënyrë që të jetë një vijë frontale e brendshme, që me durimin dhe qëndrueshmërinë e saj e motivon burrin e saj të jetë i qëndrueshëm dhe në kontinuitet të pozicionimit dhe angazhimit të tij. Sidomos koha nëpër të cilën po jetojmë, janë bërë të rrallë njerëzit e qëndrueshëm, kurse janë shtuar të pafuqishmit dhe mospërfillësit, LA HAVLE VE LA KUVVETE ILA BILAH.

Mendoj se të gjithë do të pajtoheni me mua, se hoxha, si thirrës në rrugën e Allahut, është njeriu më i nevojshëm që të ketë një grua të dal-luar, që ecën pas tij, qëndron në shtëpinë e tij dhe i ndihmon në përmbushjen e misionit të tij.

kthye në shtëpi, Hadixheja i tha fjalën e saj të mirënjohur: “Pasha Allahun kurrë nuk do të të poshtërojë Allahu. Ti i mban lidhjet me të afërmit, je i sinqertë në fjalë, i ndihmon të vobektit, fiton pasuri dhe për dallim prej të tjerëve e shpërndanë nëpër nevojtarë...”

Lëshoji “shigjetat e natës” pas mesnate dhe lute Allahun për burrin tënd

dhe për të gjithë ata që thërrasin në të Vërtetën, që t’i forcojë Allahu dhe t’ju ndihmojë. “Shigjetat e natës nuk ecin por janë të lidhura me kohën, kurse koha harxhohet” - tha imam Shafi'u.

Angazhohu me fëmijët e tu duke i edukuar dhe duke i arsimuar me dije të dobishme dhe vepër të frytshme, që e nxit frikën ndaj Allahut. Mbjelle bindjen në brenditë e tyre se parimet sa më të shëndosha të jenë, aq më i shtrenjtë është çmimi i përhapjes së tyre.

Ngrehe kokën lartë dhe krenohu me faktin se burri yt është prej bartësve të së Vërtetës dhe ji e sigurt se flamuri i së Vërtetës nuk do të bie, edhe nëse bartësi i tij rrëzohet.

Në fund:

Motër e dashur, mund të sprovoheni me padrejtësi e mundim,

Por sprovat fetarisë i shton forcën.

Një nënë ka djalë “Amarin” e tjetra vetë është Amara,

Ki besë në Zotin dhe qëndro përballë armiqve.

Besimtaret në kohët më herët bënë durim,

Përballë politeistëve në mënyrat më burrërore.

Nga arabishtja:

Muhamed DËRMAKU

Motra ime, shpresa jonë!

Dije se vuajtjet tuaja, durimi i juaj janë padyshim përfillje e urdhrit të Allahut të Lartësuar për durim dhe nxitje për të. Ndërsa për ata që durojnë në Rrugën e së Vërtetës, është meritore që të arrijnë prej Allahut shpërblimin më të përsosur.

Motra ime e dashur!

- Merre Hadixhën, Allahu qoftë i kënaqur me veprat e saj, si modelin më të mirë. Ishte mbështetësja kryesore dhe krahu më i fuqishëm i burrit të saj, të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, në bartjen e misionit të tij, ku e ndihmoi, i besoi, “e mbuloi” dhe e inkurajoi të Dërguarin me rastin e ardhjes së shpalljes për herë të parë. I Dërguari ishte i shqetësuar me fjalët “Lexo”, kur ai ishte analfabet, dhe kur u

Mes'hi mbi çorape

53

Përgjigjet: Muharem ISMAILI

Pyetje: Jam i punësuar dhe thirrja e ezanit të namazit të drekës më gjen në punë; duke pasur parasysh se çorapet i kam veshur me abdes, a e kam të lejuar t'u jap mes'h çorapeve, apo duhet patjetër që t'i lajë këmbët? Nëse lejohet, a keni argumente?

Përgjigje: Ashtu siç lejohet dhënia mes'h mesteve (të lëkurës), ashtu lejohet të dhënit mes'h çorapeve dhe këpucëve. Mugire b. Shu'be thotë: Muhamedi salahu alejhi ue selem mori abdes dhe u dha mes'h

çorapeve dhe sandaleve (këpucëve). Ka gjithashtu transmetime tjera që kanë të bëjnë me mes'hin mbi çorape, hadithe që arrijnë gradën hasen, që i transmeton Tirmidhiu (99) Ebu Davudi (125) dhe Ibën Maxhe nga Mugire b. Shu'be.

Ky është mendimi më i vërtetë dhe mendimi i shumicës së hulumtuesve të shkencës së hadithit, si Imam Ahmedi dhe të tjerë, i cili thotë: Mes'h mbi çorape transmetohet nga shtatë ose tetë sahabë të Muhamedit, salahu alejhi ve selem.



Pyetje dhe përgjigje

İbën Mundhiri thotë: Të dhënit mes'h çorapeve është transmetuar nga shtatë sahabë të Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, siç janë: Aliu, Ammari, İbën Mes'udi, Enesi, İbën Omeri, Bera'i, Bilali, İbën Ebi Eufa, dhe Sehël b. Sa'di, kurse nga dijetarët e mirënjohur, që e përkrahin këtë mendim janë: Atai, Haseni, Seid b. Musejjebi, Nehaiu, Seid b. Xhubejri, A'meshi, Theuriu, Hasen b. Salih, İbën Mubareku, Is'haku, Ja'kubi dhe Muhamedi.

Po ashtu, İbën Mundhiri duke dashur në vazhdimësi të mbrojtë këtë sunnet, thotë: Sahabët radijellahu anhum e kanë praktikuar mes'hin mbi çorape dhe asnjëherë askush nuk i ka kundërshtuar.

Kjo paraqet konsensus (ixhma') në kohën e tyre. Pra, sipas gjithë kësaj është e qartë dhe fort mirë e argumentuar se të dhënit mes'h çorapeve është e lejuar dhe nuk ka nevojë dhe as hapësirë për dyshime, por vetëm duhet bërë me zemërgjerësi dhe duhet pranuar si dhuratë nga Allahu subhanehu ve teala.

Pyetje: Si merret mes'h mbi çorape?

Përgjigje: Mes'hi i jepet pjesës së sipërme të këmbës, duke u bazuar në transmetimet që përmbajnë formën e mes'hit. Aliu radijallahu anhu thotë: *"Po të kishte qenë feja me logjikë, pjesa e poshtme e mesteve do të kishte qenë më prioritare se pjesa e epërme, kurse unë e kam parë Muhamedin, salallahu alejhi ve selem duke i dhënë mes'h pjesës së epërme të mesteve"*.

Pyetje: Sa është kohëzgjatja e mes'hit të dhënë mbi çorape?

Përgjigje: Kohëzgjatja e mes'hit të dhënë mbi çorape është një ditë e një natë për vendasin, dhe tri ditë e tri net për udhëtarin. Aliu radijallahu anhu rrëfen se Muhamedi salallahu alejhi ve selem e ka caktuar mes'hin tri ditë e tri net për udhëtarin, dhe një ditë e një natë për vendasin.

Pyetje: Cilat janë kushtet e vërteta dhe të bazuara për mes'hin mbi çorape?

Përgjigje: Për mes'hin mbi çorape janë katër kushte, nëse i plotëson ato, atëherë të lejohet dhënia mes'h.

Kushti i parë: të jenë të mbathura me abdes. Muhamedi salallahu alejhi ve selem Mugire b. Shu'bës i tha: *"Mos m'i zbath (mestet) pasi i kam mbathur me abdes"*.

Kushti i dytë: Çorapet e mbathura për mes'h të jenë të pastra, nëse janë të papastra nuk lejohet t'u japësh mes'h. Një ditë Muhamedi salallahu alejhi ve sellem ua fali namazin shokëve të vet i mbathur me sandale (këpucë) dhe gjatë namazit i hoqi nga këmbët, pastaj tha: *"Erdhi Xhibrili dhe më tregoi se i kisha sandalet e papastra"*.

Kushti i tretë: Marrja e mes'hit të jetë nga papastërtia e vogël e jo nga papastërtia e madhe (papastërti që obligon larje-gusëll). Safuan b. Assal radijellahu anhu rrëfen se Muhamedi salallahu alejhi ve selem urdhëronte që në udhëtim të mos i zbathim mestet tri ditë e tri net përveçse nga xhunublëku.

Kushti i katërt: Mes'hi mbi çorape të jetë në kohën e saj të lejuar, një ditë e një natë për vendasin dhe tri ditë e tri net për udhëtarin. Aliu radijellahu anhu rrëfen se Muhamedi

salallahu alejhi ve selem ka thënë: “I lejohet mes’hi udhëtarit tri ditë e tri net, kurse një ditë e një natë vendasit”.

Pyetje: Hoxhë i nderuar, po dëgjojmë disa njerëz duke thënë se për të qenë i lejuar mes’hi mbi çorape duhet patjetër që çorapet të jenë nga pambuku dhe të trashë, aq sa të mund të ecësh me to një distancë të caktuar, a është kjo nga kushtet e mes’hit mbi çorape?

Përgjigje: Mendimi më i saktë dhe më i argumentuar është se trashësia e çorapeve nuk qëndron si kusht, madje edhe nëse janë të tejdukshme, nuk prish punë, për shkak se me çorapet nuk është për qëllim mbulimi i këmbës, se këmba nuk është nga vendet e turpshme (avret) që duhet mbuluar patjetër, por qëllimi i gjithë kësaj është lehtësimi që gjendet në mos-zbathjen e çorapeve gjatë marrjes së abdesit. Më në fund themi se ti e ke të lejuar të mos i zbathësh çorapet gjatë marrjes së abdesit edhe nëse i ke të holla se për këtë është bërë hallall ky lehtësim.

Pyetje: A lejohet të dhënit mes’hi mbi çorape të grisura?

Përgjigje: Sa i takon të dhënit mes’hi çorapeve që janë të grisura është e lejuar. Ky është qëndrimi i shumicës së shkencëtarëve islamë, përderisa ende çorapi mund të quhet çorap. Argumentin më të fortë e gjejmë në përditshmërinë e shokëve të Pejgamberit, sallallahu alejhi ve selem, të cilët kanë qenë të varfër dhe rrallëkush prej tyre ka pasur çorape të pa grisura; megjithëkëtë, ata kanë vazhduar të marrin mes’hi mbi ato çorape të grisura. Ata kanë qenë

njerëzit më të kujdesshëm dhe më të përpiktë në çështjet fetare; nëse kjo gjë nuk do të kishte qenë e lejuar, ata me siguri nuk do ta kishin bërë, po ashtu, edhe sikur të ishte e ndaluar, Muhamedi sallallahu alejhi ve selem do t’u tërhiqte vërejtjen, sikurse vepronte në shumë raste tjera.

Pyetje: A është patjetër të dhënit mes’hi për çdo abdes?

Përgjigje: Ashtu siç është obligim larja e këmbëve për çdo abdes, e njëjta gjë vlen edhe për mes’hin mbi çorape çka është e detyrueshme për çdo abdes, për arsye se mes’hi mbi çorape është zëvendësim i larjes së këmbës. Allahu i madhëruar thotë: **“O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zgjtë”**.

Pyetje: Nëse i zbath çorapet mbi të cilat kam marrë mes’hi me harresë ose me vetëdije, duke qenë në abdes, a më prishet abdesi?

Përgjigje: Zbathja e çorapeve pasi t’u jepet mes’hi nuk e prish abdesin për shkak se zbathja e çorapeve nuk është nga gjërat që e prishin abdesin, por nuk të lejohet pas kësaj të dhënit mes’hi mbi ato çorape, dhe nëse merr abdes, duhet patjetër t’i lashë këmbët. Duke marrë për bazë një rregull që thotë: **“çdo gjë që vërtetohet me argument të sheriatit nuk anulohet përveçse me argument që tregon të kundërtën e saj”**. Abdesi i tij me larjen e gjymtyrëve është

vërtetuar në Kur'an dhe Sunet, kurse prishja e abdesit ende nuk është argumentuar dhe mbetet ashtu siç ishte i bazuar.

Pyetje: Pse ky lehtësim është shumë pak i pranuar nga njerëzit dhe nuk e pëlqejnë?

Përgjigje: Është fakt se një numër i madh i myslimanëve në trojet tona nuk e pëlqejnë këtë vepër, kjo gjë padyshim është rezultat i paditurisë fetare që është e pranishme në këto troje. Por problemi nuk ndalet këtu, është ende më i madh kur i dëgjojmë bartësit e Amanetit (hoxhallarët) duke thënë se kjo gjë është risi në Fe, nuk lejohet dhe shpeshherë argumentojnë duke thënë se kjo gjë nuk ka qenë te gjyshërit e tanë, në trojet tona; thonë: ma merr mendja; mendimi im është kështu, duke mos u bazuar aspak në argumente nga Kur'ani dhe Sunneti. Kjo situatë ka bërë që të përhapen në mesin e myslimanëve shumë çështje që nuk kanë bazë në Fe, ose shumë të tjera të mbeten të papublikuara shkaku i kundërshtimit nga të tillët. Kjo situatë s'është argument se të dhënit mes'h çorapeve s'lejohet, sepse ne, argumentet për lejimin ose ndalimin e kësaj gjëje s'i marrim nga situata e njerëzve, por nga argumentet e përmendura në Kur'an, Sunnet dhe praktikën e gjeneratave të arta.

Pyetje: Çfarë qëndrimi kanë pasur fukahatë e umetit tonë në lidhje me

mes'hin mbi çorape, e sidomos Ebu Hanifeja?

Përgjigje:¹ Fukahatë kanë rënë dakord për lejimin e mes'hit mbi çorape kur ato kanë shputë të lëkurës apo të këpucëve. Por janë kundërshtuar për mes'hin mbi çorape të thjeshta dhe atë në dy drejtime:

Mendimin e parë e përfaqësojnë Ebu Hanifeja, malikitë dhe shafitë me qëndrimin se **nuk lejohet**, ndërsa mendimin tjetër e përfaqësojnë hanbelitë dhe Ebu Jusufi me Muhamed Shejbanin (dy nxënës të Ebu Hanifës) me qëndrim se **lejohe**t.

Ebu Hanifja ka thënë: Nuk lejohet mes'hi mbi çorape përpos nëse janë nga lëkura, apo si këpucë, sepse çorapi nuk e ka kuptimin e mesteve dhe nuk mund të ecet me to, që është kusht i nënkuptuar nga hadithi që thekson mes'hin mbi çorape.

Mirëpo Ebu Hanifja është kthyer në mendimin e dy nxënësve të tij (Ebu Jusufi dhe Muhamed Shejbani) në fundin e jetës së tij. Ai (duke marr mes'h mbi çorape) ka thënë: **Po bëj atë që i ndaloja të tjerët të bëjnë**. Me këtë kanë argumentuar se Ebu Hanifja është kthyer nga mendimi i parë.

Për këtë më gjerë flitet në librat e fikhut, gjegjësisht në "Fikhu Sunne" të Sejid Sabik dhe el-Fikhu Islami" të Vehbe Zuhejlit v. 1 f. 497.

¹ Përgjigja e fundit është nga hoxha Ali Shabani

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com



EZANI

AbdulAdhim b. Bedevij EL HALEFIJ

Vendimi i sheriatit mbi ezanin

Ezani është lajmërim për hyrjen e kohës së namazit me fjalë të caktuara dhe është i domosdoshëm (farz).

Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Kur të vijë koha e namazit, le ta thërrasë ezanin dikush prej jush dhe e le të dalë imam më i madhi.”

Pra, Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, e urdhëroi këtë urdhër për ezan, kurse rezultat i urdhrit është domosdoshmëria e kryerjes së atij urdhri.

Enesi, radijallahu anhu, thotë: “Kur

"Mushrikët e preokupuan Resulullahun, salallahu alejhi ve selem, nga katër namaze ditën e Hendekut, derisa e zuri nata, atëherë Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, urdhëroi Bilalin ta thirrë ezanin, pastaj thirri ikametin dhe e fali Drekën, thirri ikametin, fali Ikandinë, thirri ikametin, fali Akshamin, thirri ikametin fali Jacinë."

Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, donte të sulmonte një popull nuk e sulmonte derisa të gdhinte mëngjesi, e të shihte a dëgjohet ezani apo jo, e nëse në atë vend nuk dëgjohej ezani, atëherë e sulmonte."

Vlera e ezanit

Muaviu, radijallahu anhu, thotë se Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Muezinët do të kenë qafën më të gjatë

Ditën e Gjykimit.”

Abdurahman b. Abdullah b. Salet Ensariu el-Mazini transmeton nga babai i tij, i cili thotë: “O Ebu Seid el-Hudri po shoh se i do dhentë dhe fushat, e kur të jesh me dhentë e tu ose në fushë e të thërrasësh ezanin për namaz ngrije zërin, se çdo xhind e çdo njeri dhe çdo send që e dëgjon zërin e muezinit do të dëshmojë për të Ditën e Gjykimit.” Ebu Seidi thotë: “Këtë e kam dëgjuar prej Resulullahut, salallahu alejhi ve selem.”

Forma e ezanit

Abdullah b. Zejd, radijallahu anhu, thotë: “Pasi që u konsultua Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, me shokët e tij në lidhje me rënien e kambanës, ndërsa ai e urrente një gjë të tillë, ngase kish përngjasim me të krishterët, duke qenë fjetur m’u fanit një ëndërr ku pashë një njeri që kishte veshur dy rrobe të gjelbra, e në dorën e tij kishte kambanën, i thashë: “O rob i Zotit a po ma shet këtë kambanë? Më tha: Ç’do të bësh me të? I thashë: Të thërrasim njerëzit me të në namaz. Më tha: A të tregoj diçka më të mirë se kjo? Thashë: “Po”. Më tha: Thuaj:

Allahu ekber! Allahu ekber!

Allahu ekber! Allahu ekber!

Eshhedu en la ilahe ilallah!

Eshhedu en la ilahe ilallah!

Eshhedu enne Muhammeden Resululullah!

Eshhedu enne Muhammeden Resululullah!

Haje ales-salah!

Haje ales-salah!

Haje alal felah!

Haje alal felah!

Allahu ekber! Allahu ekber!

La ilahe ilallah!

Pastaj u largua pak e më tha: E kur të ngjitemi për namaz, më thuaj ikametin, e kur u zgjova në mëngjes shkova te

"E kam dëgjuar Resulullahun, salallahu alejhi ve selem, duke thënë: "Kur të dëgjoni muzeini thuani ashtu si thotë ai, pastaj dërgoni salavate mbi mua, e ai që dërgon salavate mbi mua një herë, Allahu mbi të dërgon dhjetë herë, pastaj kërkoni nga Allahu për mua vesilën, e cila është një vend në xhennet i caktuar vetëm për një rob prej robërve të Allahut, e shpresoj të jem ai, kush kërkon nga Allahu për mua vesilën i lejo-het shefati im."

Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, ai më tha: “Kjo është ëndërr e vërtetë, insha Allah” dhe urdhëroi të thirrrej ezani, kurse Bilali ishte ai që e thirri këtë ezan.”

Është e pëlqyer që muzeini gjatë ezanit t'i mbledhë dy tekbirot me një frymëmarrje

Omeri, radijallahu anhu, thotë se Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Kur të thotë muezini “Allahu ekber, Allahu ekber”, ai që e dëgjon le të thotë “Allahu ekber”, e kur të thotë “Eshhedu en la ilahe ilallah”, le të thotë “Eshhedu en la ilahe ilallah”

Ky hadith aludon qartazi se muezini i tubon të dy tekbirot me një frymëmarrje dhe ai që i dëgjon ashtu i përsërit.

Kthimi në ezan është i pëlqyer

Kthimi domethënë përsëritja e dy shehadeteve me zë të ulët, pasi që të thuhet një herë. Ebu Mahdhure, radijallahu anhu, thotë se Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, i ka mësuar këtë ezan: “Allahu ekber (1 herë). Eshhedu en la ilahe ilallah. Eshhedu en la ilahe ilallah. Eshhedu

enne Muhameden Resulullah. Eshhedu enne Muhameden Resulullah. Prapë dy herë këto shehadete.”

Të thënurit “namazi është më i mirë se gjumi” gjatë ezanit të parë të namazit

Ebu Mudhuri, radijallahu anhu, thotë se Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, “... ia mësoi ezanin, në mes të tjerash edhe këtë: *“Haje al-el-felah, Haje al-el-felah, As-salatu hujrun minen-neum (2 herë), në ezanin e parë të Sabahut.”*

Ibën Resali thotë: “Është përcaktuar het-hvibi (thënia es-salatu hajrun minen neum) gjatë ezanit të parë të Sabahut, ngase ky ezan është për t’i zgjuar nga gjumi njerëzit, kurse ezani i dytë është lajmërim për hyrjen e kohës së namazit të Sabahut dhe thirrje për namaz.”

Është e pëlqyer që thirrja e ezanit të bëhet në kohën e parë të namazit dhe në namazin e sabahut para kohe

Ibën Omeri, radijallahu anhu, thotë se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Bilali e thirrte ezanin natën, e hanin dhe pinin derisa dëgjonin ezanin e Ibën Umi Mektumit.”

Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, ka treguar urtësinë e thirrjes së ezanit të Sabahut para kohës duke thënë: “*Mos ta ndalë dikush prej jush ezani i Bilalit nga syfyri i tij ngase ai e thërret ezanin natën që ta përkujtojë atë që fal namaz të natës dhe ta zgjojë atë që fle.”*

Çka duhet thënë kur të dëgjohej ezani dhe ikameti

Është e pëlqyer për atë që e dëgjon ezanin dhe ikametin të thotë atë që e thotë muzeini.

Omer b. Hattabi, radijallahu anhu, thotë se Resulullahu, salallahu alejhi ve

selem, ka thënë: “Kur të thotë muzeini *“Allahu ekber, Allahu ekber”, të përsëritni ju duke thënë njëlloj si ky, e pastaj kur të thotë “Eshhedu en la ilahe ilallah, Eshhedu en la ilahe ilallah”, të thuani njëlloj, e kur të thotë “Allahu ekber, Allahu ekber”, të thoni njëlloj, e kur të thotë “la ilahe ilallah”, le të thotë njëlloj, e kur të thotë nga zemra, hyn në xhennet.”*

E kur e kryen muzeini ezanin dhe ikametin, kurse ai që dëgjon dhe përsërit atë që e thotë muzeini duhet të thotë këto: “Abdullah b. Amër b. As, radijallahu anhu, thotë: “*E kam dëgjuar Resulullahun, salallahu alejhi ve selem, duke thënë: “Kur të dëgjon muzeini thuani ashtu si thotë ai, pastaj dërgoni salavate mbi mua, e ai që dërgon salavate mbi mua një herë, Allahu mbi të dërgon dhjetë herë, pastaj kërkoni nga Allahu për mua vesilën, e cila është një vend në xhennet i caktuar vetëm për një rob prej robërve të Allahut, e shpresoj të jem ai, kush kërkon nga Allahu për mua vesilën i lejohet shefati im.”*

Xhabiri, radijallahu anhu, thotë se Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “Ai që dëgjon ezanin e thotë duanë e ezanit, i lejohet shefati im në Ditën e Kijametit.” ALLAHUMME RABBE HADHIHI DA’VETI TAMMETE VES-SALATI KAIMEH ATI MUHAMMEDEN VESILETE VEL FADILETE VE B’ATHHU MEKAMEN MUMUUDEN LEDHIVE’ADTEH ((o Allah, Zot I kësaj thirreje të plotë dhe I namazit për të cilin thiurren njerëzit, jepoja Muhammedit Vesilën dhe faën që ia ke premtuar dhe ringjalle atë në atë pozitë të lartë, vërtet Ti nuk e then premtimin.)

Shënime:

Është e pëlqyer të bëhet dua në mes ezanit dhe ikametit, në këtë kohë duaja pranohet.

Enesi radijAllahu anhu thotë se

Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: “*Duaja nuk refuzohet mes ezanit dhe ikametit.*” ÇKA ËSHTË E PËLQYER TË BËN MUEZIN?

Muezini duhet t'i posedon këto cilësi:

1. Ta thërret ezanin vetëm për hir të Allahut, le të mos merrë para për këtë. Uthman b. Ebilasi thotë: “*I thash ja Resulullah më bën imam të popullit tim, më tha: “Ti je imam i tyre, pasoj të dobët të popullit tonë e merre një muezin që nuk merr para për të.”*”

2. Të jetë i pastër prej dy pastërtive siç e kemi përmendur më herët.

3. Të jetë i ngritur dhe i drejtuar nga Kibla. Ibën Mundhiri thotë: “Gjithnjë dijetarët Islam janë të pajtimit se të ngriturit në këmbë gjatë ezanit është prej Sunnetit, gjithashtu prej Sunnetit është të kthyerit drejt Kiblës, ngase muezinët e Resulullahut, salallahu alejhi ve selem, e thirrnin ezanin duke qenë të kthyer nga Kibla.”

4. Të kthejë kokën në të djathtë kur të thotë “haje ales-salah” e në të majtë “haje alal faleh”. Ebu Xhuhejfeja thotë: “*E kam parë Bilalin duke thirrë ezanin, e përcillësha gojën e tij duke thirrë këndej e andej.*”

5. Me i futë gishtat në vesh. Ngase Ebu Xhuhejfeja thotë: “*E kam parë Bilalin duke thirrë ezanin... dhe i shtinte gishtat në vesh.*”

6. Të ngritë zërin gjatë thirrjes së ezanit. Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, thotë: “*Çdo xhind a njeri dhe çdo send që dëgjon zërin e muzeinit e dëshmon Ditën e Gjykimit.*”

Sa duhet lënë hapësirë mes ezanit dhe ikametit

Duhet ndarë ezanin dhe ikametin me një hapësirë kohore që i mundëson individit të përgaditet për namaz dhe i

mundëson të merr pjesë në të, ngase ky është qëllimi i ezanit. Ibën Batal thotë: “Kjo hapësirë kohore nuk është e caktuar por kushtëzohet që të hyjë koha dhe të tubohen namazlitë.”

Ndalohet dalja prej xhamisë pas thirrjes së ezanit

Ebu Sha'tha, radijallahu anhu, thotë: “*Ishim ulur në xhami me Ebu Hurejren, thirri ezani e njëri doli nga xhamia kurse Ebu Hurejra e përcolli me shikim dhe tha: “Ky njeri bëri mëkat ndaj Ebu Kasimit.”*”

Thirrja e ezanit dhe ikametit për namazin e kompenzuar

Atë që e zë gjumi nga namazi ose harron, i përcaktohet që të thërret ezanin dhe ikametin, ngase Ebu Davudi transmeton dhe tregon tregimin që e ka zënë gjumi Resulullahun, salallahu alejhi ve selem, dhe sahabët e tij në namazin e Sabahut duke qenë në udhëtim, e kur u zgjua Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, urdhëroi Bilalin ta thirrë ezanin dhe ikametin.

Nëse ka kaluar më tepër se një namaz, atëherë e thirrë një ezan kurse për çdo namaz e thirrë ikametin, duke u bazuar në hadithin e Abdullah b. Mes'udit, radijallahu anhu, që ka thënë: “*Mushrikët e preokupuan Resulullahun, salallahu alejhi ve selem, nga katër namaze ditën e Hendekut, derisa e zuri nata, atëherë Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, urdhëroi Bilalin ta thirrë ezanin, pastaj thirri ikametin dhe e fali Dreken, thirri ikametin, fali Ikindinë, thirri ikametin, fali Akshamin, thirri ikametin fali Jacinë.*”

Zgjedhi: Agim BEKIRI

"Umdetul Ahkam"

"Esenca e dispozitave të legjislacionit islam"

Shkruan: Sedat SHABANI

Disa fjalë për autorin :

Ndonëse biografinë e autorit kemi patur rastin ta përmendim gjatë paraqitjes së librit "Shkëndija nga jeta e të Dërguarit dhe dhjetë të përgëzuarve", po e përsërisim sërish në pika të shpejta.

Abdul Ganij El Makdisiu:

Quhet Abdul Ganij b. Abdul Vahid b. Alij b. Surur El-Xhemaili El-Makdisij El-Hanbeli. Lindi në vitin 541H në Bejtul Makdis në vitin në të cilin lind Imam Muveffek Ibën Kudame nga i cili dallohet për shkak të animit kah hadithi në kohë që Ibën Kudame anonte kah lëmia e fikhut. Udhëtoi në Bagdad për të mësuar dhe atje u takua me shumë dijetarë të njohur, siç ishin: Abdul Kadir El Xhejlani dhe Ibën Muni, biografinë e të cilit e shkroi. Pas Bagdadit udhëtoi në Egjipt, Esbahan, ku u takua me dijetarët e vendit, përfitoi prej tyre, që më vonë të kthehet në Damask, ku përfundoi udhëtimin në kërkim të diturisë.

Autor: Hafidh Abdulgani el Makdesi
Përktheu: Bledar Albani
Faqe: 228
Botues: Essebil
Kosovë 2007

Veprat e tij:

Numri i librave që i shkroi kalon 40-shin.

Ndër ta mund të përmendim:

El Misbah fi ujuni el ehadith es-sihah

Tuhfetut-talibin fil xhihadi vel muxhahidin

Mihnetul Imam Ahmed

Fedailu Mekke

Dhemmur-rija

El Xhami' Es-Sagir li ahkam el Beshir en-Nedhir

El Athar el murdiije fi fedaili hajril berijje

Umdetul ahkam (ky libër) dhe tjerë

Ndërroi jetë ditën e Hënë me 23 Rebi'ul Evvel në vitin 600 sipas hixhrit. Allahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjerë (marrë nga www.albislam.com).

"Esenca e dispozitave të legjislacionit islam", apo i njohur në botën Islame me titullin në arabisht **"Umdetul Ahkam"**, është një vepër me të cilën u



njoha qysh herët, sikundërse edhe shumica e shokëve të mi, në daljen time në botën arabe, kur pyetja dijetarët e mëdhenj, si shejh Abdul Kadër Arnauti dhe shejh Albani, Allahu i mëshiroftë, që të më këshillonin libra që do të më ndihnin në kërkim të dijes. Ata, si shumica e dijetarëve, propozuan këtë libër në lëmin e fikhut, duke më këshilluar që ta mësoja tekstin e këtij libri përmendsh, pasi përbëhet prej haditheve të vërteta të dy sahihave Buhari dhe Muslim.

Edhe më tej, si shumica e dijetarëve, propozuan këtë libër në lëmin e fikhut, duke më këshilluar që ta mësoja tekstin e këtij libri përmendsh, pasi përbëhet prej haditheve të vërteta të dy sahihave Buhari dhe Muslim.

Është libër i fikhut sipas metodologjisë së dijetarëve të hadithit. Siç përmend edhe vetë autori në parathënie të librit, arsyeja pse e shkroi këtë libër shpjegohet me këto fjalë: “Disa vëllezër më kërkuan t’u përmbledhja disa hadithe të dispozitave të sheriatit, prej atyre haditheve që përputhen (për nga teksti dhe emri i sahihut transmetues) në dy sahihat e imamëve Ebu Abdullah Muhammed b. Ismail b. Ibrahim el Buhari dhe Muslim b. el Haxhaxh b. Muslim el Kushejri en Nejsaburi. Dhe unë iu përgjigja kërkesës së tyre duke shpresuar dobinë prej tij.”


Ky libër ka qenë shtysë për shumë dijetarë që të shkruajnë dhe të komentojnë në lëmin e fikhut komperativ, janë botuar disa komente të këtij libri, që sot janë ndër më të njohurit, ku dallohet ai i dijetarit të madh të hershëm Ibn Dakik el-Idi rahimehullah, “Ihkamul Ahkam”, dhe komenti i shejh Abdullah Alu Bessami “Tejsirul alam sherh umdetul ahkam”. Sakaq, vlen të përmendet edhe komenti që bëri afër dhjetë vite në Medinen e Resulullahit sallallahu alejhi ve selem shejh Muhammed Muhtar esh Shenkiti.

Ndryshe nga të tjerët, ky koment nuk është shkruar në libër, por gjendet i incizuar nëpër disqe dhe prej tij përfituan shumica e hoxhallarëve tanë që studiojnë në “Universitetin Islamik” të Medinës.

Autori ka bërë përmbledhjen e haditheve të Buhariut dhe Muslimit në nëntëmbëdhjetë kapituj të fikhut; fillon nga “Kapitulli i pastërtisë” dhe përfundon me “Kapitulli i lirimi nga skllavëria”. Sipas nevojës, kapitujt përmbajnë një apo më shumë tema dhe përmbajnë vetëm hadithe të Resulullahit sallahu alejhi ve selem edhe atë nga dy koleksionet e vërteta Buhariut dhe Muslimi, çka i jep librit vlerë dhe e bën udhërrëfyes për hoxhallarë të mëdhenj, për nxënës dhe për masën e gjerë.

Vlen të përmendet se aktualisht libri është duke u komentuar në gjuhën shqipe në internet (paltalk) nga hoxha Omer Berisha, ku pritet të botohet me koment në të ardhmen, me lejen e Allahut. Shpresojmë se në të ardhmen, siç edhe i thashë botuesit, do të ishte mirë të ceket titulli në arabisht i këtij libri “Umdetul Ahkam”, pasi ky libër është i njohur në krejt botën me këtë emër, siç është libri “Rijadus Salihin” apo “Sahihul Buhari” etj. të cilat është bërë zakon që edhe në botimet në gjuhë e ndryshme të botës t’i ruhen titujt në origjinal.

Allahu shpërbleftë me xhennet autorin e librit, përkthyesin dhe botuesit të këtij libri i urojmë punë të bereqetshme në afirmimin e diturisë dhe urtësisë të muslimanët shqiptarë.



1. LUFTA E ÇANAKALASË
 Autor: Mehmed Nijazi



2. MËKATET E MËDHA
 Autor: Imam Dhehebi

Abonues të nderuar

*Me qëllim që t'ju arrijë çdo numër
 i revistës, ju lutemi:*

- Emrin, mbiemrin dhe adresën ta shkruani të plotë dhe valide;
- nëse ndërroni vendbanimin, të na shkruani menjëherë në alhislam@gmail.com
- nëse pranoi letër-përkuftim se ju ka skaduar pagesa, atëherë vetëm na shkruani se dëshironi të vazhdoni abonimin dhe ne nuk ua ndërpresim dërgimin.

Ju faleminderit



*** FLÜGGER GJALLËRON DHE ZGJATË JETËN E AMBIENTIT TUAJ.**

*** MBI 3000 NIANSA TË NDRYSHME**

**F.a.g - Kom
Shkup - Maqedoni**

**Tel : + 389 (2) 2600 154
Faks : + 389 (2) 2601 248
rr. Xhon Kenedi nr. 9a lok.14**

**E-mail : fag_color@yahoo.com
Web : Flugger.com**

